



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik
Kuvendi i Komunës
-Kryesuesi i Kuvendit-

01Nr. 60/01-13696/22
Kaçanik, 20.05.2022

FTESË PËR MBLEDHJE

Të nderuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës,

Në bazë të nenit 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, e thërras mbledhjen e V (Pestë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2022.

Mbledhja do të mbahet në sallën e kuvendit të komunës, në katin e tretë të objektit të komunës, me 31 Maj .2022 (e Martë) në ora 11:00.

Mbledhjen do ta kryeson dhe udhëheq, Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Ju mirëpresim!

Me respekt!

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

Në mbledhjen e Kuvendit të Komunës të datës 31.05.2022, do të shqyrtohet ky:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e kuvendit të komunës;
2. Draft-Rregullore për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të Palestrës sportive në komunën e Kaçanikut;
3. Programi komunal trevjeçar i banimit për vitet 2022-2025;
4. Plani komunal për integritet 2022-2026;
5. Propozim-Vendimi për ndryshimin e thirrjes, Shkolla e Mesme Profesionale – ShMP “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka”, në Institucion i Arsimit dhe Aftësimit Profesional - IAAP “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka”;
6. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të sipërfaqes 300m² në parcelën kadastrale 00255-3 zona kadastrale Vatë-Dubravë, me kulturë bujqësore Arë e klasës 5, në emër të Xhevxhet (Ahmet) Mema nga f. Dubravë;
7. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të sipërfaqes 300m² në parcelën kadastrale 00311-0 zona kadastrale Ivajë, me kulturë bujqësore Livadh i klasës së 6, pronë e Samedin (Vehbi) Rexha nga Kaçaniku.

Shtojca; Materialet për pikët sipas agjendës.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

01Nr. 60/01-11080/22
Kaçanik, 29.04.2022

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **IV (katërt)** e rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2022 (Legjislatura e shtatë), mbajtur me 29.04 2022. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje fillimisht ishin 26 anëtarë, gjatë shqyrtimit të pikës 2 arriti edhe anëtarja Fitore Vishi, kështu që pjesëmarrës të kësaj mbledhje ishin 27 anëtarë.

Prej strukturave ekzekutive të komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Nënkyetari i Komunës-Sabedin Vishi, Drejtorët e drejtorive: Qamil Stagova-DUKMM, Dardana Tafili-Dauti-DAP, Sali Malsiu-DSHMS, Pranvera Loku-Zharku-DZHET, Bahri Selimi-DBF, Ramadush Osmani-DSHPE, Zahir Doda-DA, Suhad Dullovi-DBPZHR, ndërkaq nga zyrtarët e komunës ishin: Fatlume Guri-Selimi, Bejtulla Dalloshi dhe Arbnora Kuka.

Nga OSBE, mbledhjen e monitoroj, Faruk Dërmaku.

Nga strukturat vendore mbledhja monitorohet përmes Telprezencës nga Gëzim Sahiti-zyrtarë i lartë për monitorim të komunave në MAPL.

Mbledhjen e kryesoi Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit,
Procesmbajtëse Makfire Malsiu.

Kryesuesi i Kuvendit z. Kemal Murseli: Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari iu përshëndes të gjithëve, iu dëshiroj mirëseardhje, konstatoj pjesëmarrjen duke i thirrur emër për emër, kushte pune për tu mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e IV (katërt) të rregullt të kuvendit të komunës për vitin 2022, data 29 prill, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;
2. Raporti Financiar për periudhën, Janar-Mars 2022;
3. Propozim Vendim për transferin e mjeteve nga rezerva komunale sipas buxhetit të vitit 2022;
4. Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private ZK Bob, parcela me nr. 175-0;

5. Propozim Vendimi paraparak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, PK 00824-11 ZK Strazhë, me kulturë tokë pyjore- Mal i Klasës 4, me sipërfaqe 637 m², pronë e Kadri (Faik) Lalinovci nga Ferizaj;
6. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, PK 01402-1 ZK Soponicë, me kulturë bujqësore Arë e Klasës së 5, me sipërfaqen 3917m², pronë e Ekrem (Ramadan) Hyseni nga Ferizaj, nën qiramarrje 99 vjet;
7. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, PK 00311-0 ZK Ivajë, me kulturë bujqësore Livadh i lasës së 6, në sipërfaqen 300m², pronë e Samedin (Vehbi) Rexha nga Kaçaniku;
8. Propozim Vendimi për emërimin e komisionit përzgjedhës për drejtor të institucioneve arsimore;
9. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore PK 01123-6 ZK Kaçanik i Vjetër, me kulturë bujqësore Arë e Klasës 6, me sipërfaqe 600 m², pronë e KBI;
10. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore PK 0001952-0 ZK Kaçanik, me kulturë bujqësore Arë e Klasës 6, me sipërfaqe 600 m², pronë e KBI;
11. Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private ZK Begracë, 17 parcela të evidentuara në emër të N.P.P.T.T.SH. ALK-OIL me nr. të biznesit 70052105;
12. Propozim Vendimi për shfuqizimin e vendimit 01Nr. 327/09 - për bartjen (delegimin) e kompetencës.

Lidhur me Rendin e propozuar të punës e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës,

APROVON

Rendin e punës në përbërje prej 12 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikëve sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës;

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin e keni marrë, nëse ka kush diçka lë të urdhëroj: Për vërejtje nuk u paraqit kush, atëherë Procesverbalin e mbledhjes së kaluar të KK e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

APROVON

Procesverbalin e mbledhjes së Kuvendit të Komunës e datës 31.03.2022 / Lënda: 01Nr. 60/01-8446/22.

Kryesuesi i Kuvendit: Kalojmë në pozicionin e pyetjeve dhe kërkesave;

Pyetje dhe Kërkesa

znj. Ardita Rrahmani: Shqetësimet dhe kërkesat e qytetarëve të Kaçanikut jemi në ata të cilët kemi autorizimin t'i drejtojmë dhe paraqesim tek ju.

1. Tash e 22 vite të juaj në pushtet, dhe ende në komunën tonë problem i parë i secilit qytetarë të secilit lokalitet në Kaçanik vazhdon të mbetet, rrjeti jo funksional i kanalizimit dhe përrrenjve. Përveç kundërmimit të vazhdueshëm, ku për pasojë mund të sjellë edhe sëmundje, vazhdon të mbetet e paqartë se si mund të ndërtohen rrugë pa u bërë fillimisht pastrimi i rrjetit të kanalizimit. Si pasojë e një pune "shkel e shko", problemet mandej janë të ndërlidhura dhe të njëpasnjëshme. Po flas për vendosjen e kubëzave në rrugën "Ismail Qemajli" në Kaçanik, po ashtu në qendër të qytetit, do të thotë pak metra nga objekti i komunës mbrapa ndërtesës së Tropikalit dhe mes objektit të ndërtesave të reja në rrugën "Qamil Ilazi", këtu të banesat e topojanëve.

2. Problem i njëjtë me shaktin është edhe në rrugën që qon tek shkolla fillore "Emin Duraku" në Dushkajë, përroska në rrugën "Mejdi Dalloshi" përroskë kjo ku rrezikohen 9 familje që janë aty, përroi në lagjen "Rakoc", përroi ky që vitet e fundit është lënë në harresë për nga pastrimi, e që lavdin e asaj zonë e ka në kujtesë secili nga ne që edhe jemi të pranishëm në këtë sallë. Kam një pyetje: Kur do të merren masa rreth pastrimit dhe rregullimit, sanimit të këtyre problem në këto lokalitete?

3. Shqetësim tjetër është edhe, mungesa e kontrolleve specialistike në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Kaçanik, kur jemi komunë me mbi 30 mijë banorë, e nevojat për shërbimet shëndetësore janë jo të nevojshme por të domosdoshme. Mungesa e shërbimeve specialistike kundrejt qytetarëve të komunës përveç që është e padrejtë, po ashtu ka një kosto të madhe duke e ditur edhe standardin e qytetarëve dhe çmimet marramendëse të këtyre shërbimeve në klinika/ordinanca private kryesisht jashtë komunës tonë. Shërbimet specialistike do t'iu lehtësonin jetën secilit qytetar të komunës tonë dhe pushteti e ka për detyrim të e ofroj këtë shërbim, jo se po e kërkon një asambleiste e opozitës, por po e kërkojnë qytetarët e komunës tonë.

z. Bashkim Luma: E shprehi një shqetësim për DSHPE, me konkretisht drejtorin, Ramadush Osmani. Shqetësimi i banorëve të f. Gllloboçicë është për bllokimin e rrjetit të kanalizimit, i cili bllokim ka sjellë deri të grumbullimi i ujërave të zeza i mbetjeve të organizmit të fekaleve, me çka ka ardhur deri të kundërmimi i erërave. Disa prona që janë në afërsi të grumbullimit të ujërave të zeza, më herët kanë qenë të mbjella, mirëpo në këtë vit nuk mund të mbillen për shkak të këtij defekti të krijuar. Drejtori ka qenë aty prezent për të parë defektin e krijuar, por ende nuk është marrë ndonjë veprim i duhur. Kërkoj nga kjo drejtori të merr veprime sa më të shpejta që është e mundur për sanimin e defektit të krijuar.

z. Agim Çaka: Unë në këtë mbledhje do t'i ngriti tre çështje:

1. Prerja e pyjeve; Është problematikë e cila sigurisht kjo çështje është diskutuar në seancat e legjislaturës së kaluar. A ka masa shtesë rreth këtij problemi, sepse masat e marra deri me tani po shihet se nuk janë treguar efektive, kur dihet se prerja dhe dëmtimi i pyjeve po vazhdon. Duke marrë parasysh se është shtuar rritja e shfrytëzimit të drurit, unë e shoh si problematikë këtë çështje. A është marrë ndonjë masë shtesë që do të parandaloj dëmtimin dhe prerjen e pyjeve? A ka mundësi nga DBPZH të merren veprime të nevojshme, ashtu si janë marrë më herët, për pyllëzimin e pyjeve përmes aksioneve me nxënës të shkollave, sepse një aksion i tillë është mirë edhe për nxënës për risocializimin e tyre?

2. Kalaja e qytetit; A po shfrytëzohet si monument historik, apo po keqpërdorët, keq-shfrytëzohet e degradohet ? Unë nuk shoh se ka ndonjë iniciativë, që ky monument historik me u shfrytëzuar si kapital i komunës. për turistë nga rajonet tjera. Për mua paraqet problem serioz sesi po shfrytëzohet kalaja e qytetit në Kaçanik.

3. Lumi Neredime; Lumi për momentin ka ujë dhe nuk paraqet shumë problem, por nuk bënë me pritje me shteruar uji, e me u përballë me problemit e ujërave të zeza. A ka komuna ndonjë projekt për menaxhimin e ujërave të zeza që derdhen në lum, sepse vjen momentin kur kundërmon lumi nga to ? Ky është shqetësim i qytetarëve të komunës, sepse nëse kundërmon lumi, nuk ka më vend për shëtitje në bulevard.

z. Kadrije Lika-Troni: Nga iniciativa kam pranuar një kërkesë për themelimin e Muzeut historik në Kaçanik. Pyetja është: Ku ka ngelë çështja dhe është marrë ndonjë veprim në këtë drejtim ?

Kryesuesi i Kuvendit: Pyetje e Kërkesa tjera nuk ka, kalojmë në pikën e dytë:

2. Raporti Financiar për periudhën, Janar-Mars 2022;

Drejtori është prezent në mbledhje, fillimisht ia kaloj fjalën drejtorit, pastaj e hapi diskutimin:

z. Bahri Selimi: Në raport janë paraqitur në detaje mjetet e shpenzuara të buxhetit komunal. Janë shpenzuar 15.66% e 1.439.190€, krahasuar me vitin paraprak kemi zvogëlim të buxhetit të shpenzuar. Sqarimi është dhënë edhe në KPF. Kjo periudhë ka të bëjë me shlyerjen e obligimeve nga viti paraprak. Janë paguar shpenzimet 37.000€, dhe kështu ka rezultuar shpenzimi prej 8.22%. Të gjitha aktivitetet tjera janë zhvilluar normal pa ndonjë ngecje. Të HVK shihet se ka inkasim të mirë, 23.54%, 162.300€, krahasuar me buxhetin e aprovuar. Të HVK të TP kemi rënie të inkasimit për shkak të ndryshimit të një rregulloreje qeveritare ku është hequr kushtëzimi i pagesës së regjistrimit të veturave, me çka qytetarët nuk obligohen për pagesën e TP. Komuna ka iniciuar procedura përmbartimore për obliguesit që kanë borxhe, në këtë mënyrë është rritur niveli i inkasimit. Të TP kemi nën inkasim për 3800€, të tatimi në tokë kemi ngritje për 2675€. Nëse i bëjmë bashkë këto dyja, del 1124€ minusi. Të hyrat tjera kanë shkuar në mënyrë të rregullt. Për herë të parë e kemi, pasqyrën e inkasimit nga inspektorati që ka qenë shqetësim edhe i legjislaturës së kaluar. Tani me statut të komunës, është i ndarë si zyre inspektoratin dhe e kemi pasqyrën e të hyrave, 1044€ janë inkasuar nga ky sektor. Pagat dhe mëditjet janë 23.63%, 16.26% Mallrat dhe shërbimet 5.92% Shpenzimet komunale, Subvencionet dhe transferet 8.8 0.9% Investimet kapitale. Të IK po e jap një sqarim, se është kjo përqindje se nuk kemi pasur obligime, vetëm një obligim e kemi pasur 1924€ i cili është paguar. Drejtori i dha me shifra për secilën kategori shpenzuese buxhetore, ndërkaq shtoj se shpenzuesi me i madh janë: Pagat dhe mëditjet, pastaj Mallrat dhe shërbimet e kështu me radhë, ndërkaq shpenzuesi me i madh nga sektorët është, Arsimi, pastaj Shëndetësia, Administrata. Janë tabelat analitike për krejt programet shpenzuese buxhetore, shihen kursimet aty ku ka pasur mundësi me kursyer, kemi 170€, ndërkaq aty ku ka ndonjë ngritje të shpenzimeve, ka të bëjë me shlyerje të obligimeve.

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin e kësaj pike:

z. Rrustem Zenuni: Kam në pyetje për drejtorin: Sa ka pasur efekt negativ Rregullorja e cila është ndryshuar të tatimi në pronë, kur dihet se ka qenë një mjet i mirë për me inkasuar të hyra? I përgëzoj, kryetarin, drejtorët, stafin për performancën e mirë të komunës, e konfirmuar nga ministria, uroj të vazhdoni kështu edhe tutje. Në këtë drejtim, komuna ka qenë meritore edhe në vitin e kaluar.

z. Agim Mani: Të Raporti financiar janar mars 2022, krahasuar me vitin e kaluar të njëjtës periudhë, inkasimi është më i vogël, ndërkaq shpenzimet e realizuara janë më të mëdha për 7339.27€, d.m.th janë rritur shpenzimet komunale, ndërkaq janë zvogëluar shpenzimet kapitale për 97%, 83393€. Nga raporti shihet së shpenzimet e ujit janë 0, të mbeturinat ka pasur shpenzime vetëm të shëndetësia, ndërkaq shpenzimet e rrymës kanë pësuar rritje për 7250€. Qysh mundet ky dallim kaq i madh i shpenzimeve të rrymës, në krahasim me vitin e kaluar? Të këto shpenzime, a mos keni pasur parapagim nga viti i kaluar? Të pagat dhe mëditjet, shpenzimet janë më të mëdha në vitin 2021 sesa në vitin 2022, 82792€ ku është arsyeja ? Numri i punëtorëve nuk ka mundur me u rritur aq shumë për me ndryshuar aq shumë shpenzimet për paga dhe mëditje.

z. Bahri Selimi: Të pyetja e parë, Rregullorja nuk është bërë me asnjë diskutim publik, nuk është pyetur asnjë komunë si kemi me i zëvendësuar këto të hyra, ndërkaq rregullorja ka pasur ndikim negativ të krejt komunat. Nga raportet tre mujore nëse i shikojmë me komunat tjera, jemi e vetmja komunë që nuk kemi pësuar rënie, sepse iu kemi ndenjur gati procedurave përmbarimore. Qarkoret na kanë ardhur me planifikuar buxhetin e vitit 2023 dhe asnjë analizë nuk bëhet, kur dihet se mundem me i pasur ne të HVK me të vogla, se mundësitë janë zvogëluar për inkasim. Të shpenzimet komunale, kërkesat kanë qenë të vazhdueshme në investime për ndriçim publik, ku është shtuar rrjeti i ndriçimit publik, kështu edhe numri i faturave ka ardhur duke u rritur si njësor. Në raportet tjera, shpenzimet e energjisë elektrike do të jenë tepër të larta, për shkak të shtrenjtimit të energjisë elektrike. Të pagat, vjet ka intervenuar ministria, sidomos sektori i shëndetësisë, Në vitin 2022 numri i punëtorëve është i njëjtë, ndërkaq shpenzimet janë më të vogla, shpenzimet për paga shtesë i ka mbuluar ministria e shëndetësisë.

z. Agim Mani: Ku është arsyeja për një dallim kaq të madh të shpenzimeve për paga dhe mëditje në vitin 2021, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022 ?

z. Bahri Selimi: Staf nuk kemi hequr nga puna, ndërkaq mundem edhe me email me t'i përcjellë shpenzimet për pagat shtesë të vitit 2021.

z. Agim Çaka: Të HVK të gjobat e trafikut 4950€ janë vlera totale e tyre, është një vlerë bukur e madhe e këtyre mjeteve të grumbulluara. Me intereson të di, nga kanë ardhur këto të hyra, të çfarë natyre janë këto gjoba, a janë për shkak të parkingut, apo shpejtësia në komunikacion? Nëse del që këto mjete janë mbledhur si rezultat i mungesës së parkingut, problemi është të ne, se ne si komunë nuk e kemi rregulluar këtë çështje. Qytetarët kur kanë mungesë të parkingut, iu imponohet me parkuar veturën në trotuar apo diku tjetër. Në kohën e ramazanit është ndër nevojë shumë e madhe për parkingje. Gjobat ka pasur mundësi me rezultuar në mungesë të parkingjeve, sepse nevojat e qytetarëve me kryer shërbime janë të ndryshme. Ne si komunë duhet me rregulluar këtë çështje, se nuk është në rregull për një parking në kohë të shkurtër, qytetarit me iu shqiptuar gjoba.

z. Bahri Selimi: Të hyrat nga gjobat e trafikut, iu alokohen komunave, varësisht ku realizohen. Besoj se pjesa me e madhe janë në magjistrale, ndërkaq nuk i dimë saktë se nga kanë ardhur, këtë mund të kuptojmë vetëm në bazë të ndonjë raporti të policisë.

z. Agim Çaka: Mua me interesoj vlera e madhe e mjeteve të grumbulluara nga gjobat e trafikut nga kanë ardhur. Nëse kanë ardhur si rezultat i shpejtësisë, kjo është në rregull, ndërkaq nëse kanë ardhur si rezultat i fajit të komunës për mungesë të parkingjeve, ne si komunë duhet me u marrë me këtë çështje.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka, atëherë konstatoj se Kuvendi i Komunës , u ,
NJOFTUA

Me Raportin Financiar për periudhën, Janar-Mars 2022/ Lënda: 01Nr. 05-400/01-10486/22.

3. Propozim Vendim për transferin e mjeteve nga rezerva komunale sipas buxhetit të vitit 2022;

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin e keni marrë, drejtori është këtu, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Adnan Reka: Unë fillimisht e kam një pyetje; Sa janë rezervat komunale ? Nga të HVK janë vetëm 35.000€, mjetet tjera në shumë afër pesëqind e 90 mijë euro janë nga rezervat komunale. A jam i saktë në këto shifra që i theksova ? A janë në pyetje me u transferuar 625 mijë euro, se 535 mijë janë të tabela me parë, të e dyta janë 90 mijë, e që në total bëjnë 625 mijë euro.

z. Bahri Selimi: Mjetet që transferohen janë 270 mijë euro nga rezervat, këto mjete transferohen në investime kapitale.

z. Adnan Reka: D.m.th nga të HVK janë 50 mijë, se mua po me dalin 35 mijë, por nuk ka rëndësi, këto tjera a janë nga rezervat komunale. Të HVK ne e dimë se kemi të drejtë me i bartë nga viti paraprak, ndërkaq grantet qeveritare nuk e di se qysh barten.

z. Bahri Selimi: Ne në vitin 2021 e kemi miratuar buxhetin e vitit 2022 me listën e specifikuar të projekteve kapitale. Këto mjete kanë qenë të parapara për këto projekte, mirëpo me UA të ri kanë ndryshuar disa rregulla për të cilat ne dhe komunat tjera ende nuk po mundemi me u adaptuar. Ne kemi vazhduar me avazin e vjetër, ashtu që nuk i kemi specifikuar bash mirë projektet p.sh. i kemi lënë projektet me emra të vjetër. Ministria na i ka kthyer dhe na ka thënë këto mjete 270 mijë euro rrinë në rezervë, derisa ju edhe një herë t'i plotësoni në një program që është për investime publike. Të bujqësia pika 1.2 shuma 40mijë euro nga GQ, transferohen të bujqësia në kodin funksional. Ndërtimi i kanalit të ujitjes në fshatra, Doganaj, Soponicë dhe Nikaj, na është kthyer ky projekt për gabime, se ne nuk e kemi shënuar se kur e kemi me buxhet kemi bërë gabime, e kemi shënuar projektet zhvillimore për bujqësi dhe blegtori, projekt ky pak si i pa definuar. Ata na kanë thënë specifikoni projekte dhe në rregull jemi. Kjo vlen edhe të projektet tjera, Rregullimi i shëtitoreve, kanë qenë të paspecifikuar. Të planifikimi urban është shuma 60 mijë euro, të Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve në pjesën urbane dhe rurale dhe në projektin, Rregullimi i shtretërve të lumenjve dhe përroskave, këtë na e kanë kthyer se ne e kemi pasur një projekt, Hartimi i projekteve dhe nuk na e kanë pranuar sepse hartimi i projekteve bëhet nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve. Ata kanë kërkuar që këto mjete të transferohen në projekte specifike. Këto mjete ne i kemi dërguar në projekte specifike, janë me plan ekzistues, e kanë kodin, janë të miratuar në kuvendin e Kosovës dhe në këtë kuvend, dm.th nuk ndryshon buxheti i miratuar, veç kategoritë rezerva zhduket dhe shndërrohet në kategori kapitale ku e kanë pasur vendin. Me Ligjin e financave publike dhe përgjegjësitë, lejohet bartja e rezervave nga GQ 100% në kategori tjetër buxhetore. Kemi pasur bartje të rezervës edhe në vitin e kaluar, për shkak të kontratës kolektive në arsim, komplet është bartur rezerva në përmbushje të një pjese tjetër të marrëveshjes kolektive.

z. Adnan Reka: Faleminderit drejtor për sqarimin. Ne- LVV konsiderojmë se është bërë një keq planifikim, andaj do të votojmë Kundër transferit të mjeteve të propozuara.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua me 16 votë Për (12 anëtarët nga PDK, 2 anëtarët nga AAK dhe anëtari nga NISMA dhe 1 anëtar nga LDK), Kundër ishin 8 anëtarët nga LVV, Abstenuan 3 anëtarë nga LDK. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për transferin e mjeteve nga rezerva komunale sipas buxhetit të vitit 2022/ Lënda: 01Nr. 400/01-10746/22.

4. Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private ZK Bob, parcela me nr. 175-0;

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin e keni marrë, kjo pikë është trajtuar edhe në KPF, drejtori është këtu, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Naim Beça: Ne kemi propozuar me pasur TV këtu, për me i pa me qartë shpronësimin e pronave apo këmbimin e tyre. Shumica e anëtarëve të KK mund të mos i dimë ku janë këto prona, kështu që me pasur një TV me lidhur me internet me google MAP, i kishim pasur me të qarta për me marrë një vendim se a me votuar, për, kundër apo abstenim. Unë nuk e njoh atë pjesë, kështu që nuk mund të jam as për as kundër këtij propozim vendimi.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua me 15 votë Për (12 nga PDK, 2 nga AAK, 1 nga NISMA), Kundër votë nuk ka, Abstenuan 12 anëtarë (8 anëtarët nga LVV, 4 anëtarët nga LDK). Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private, zona kadastrale Bob, parcela me nr. 175-0, Arë e klasës 3 në emër të Emrush (Rufat) Dema, në këmbim me pronën e komunës me numrat: 176-0 dhe 159-0 ZK Bob/ Lënda: 01Nr. 06-941/01-7953/22.

5. Propozim Vendimi Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, PK 00824-11 ZK Strazhë, me kulturë Tokë Pyjore- Mal i Klasës 4, me sipërfaqe 637 m², pronë e Kadri (Faik) Lalinovci nga Ferizaj;

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin e keni marrë, drejtori është këtu, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Në këtë pikë nuk iu keni referuar ligjit në mënyrë të drejtë, sepse ligji që e rregullon këtë çështje, nuk e lejon që KK me ia ndërruar destinimin. Ju keni referuar nenit 6.3, ndërsa pika 6.2 ndërrimi i destinimit të përhershëm të tokës bujqësore të klasës nga 1-4 do të bëhet me vendim të KK, pas marrjes së pëlqimit të ministrisë. Kjo pronë është e klasës 4 dhe ne nuk kemi asnjë dokument nga ministria me lejuar këtë ndërrim destinimi. Unë mendoj se kjo është një bazë e jashtëligjshme.

Kryesuesi i Kuvendit: Kjo pikë është futur në rend pune, për faktin se kemi të bëjmë me vendim paraprak e jo me vendim përfundimtar. Arsyeja është, unë u konsultova edhe me drejtorin. Mministria po kërkon një konfirmim paraprak nga komuna, sepse ministria nuk

është në gjendje me i ditur të gjitha pronat e komunës. Ky vendim shkon në ministri të bujqësisë për trajtim. Ky është një vendim paraprak me i treguar ministrisë një pasqyrë se komuna është në rregull për ndërrimin e destinimit, pastaj vlerësimin profesional e jep ministria e bujqësisë.

z. Adnan Reka: Ashtu si po thoni ju, atëherë pse nuk iu keni referuar nenit 6.2 që flet për ndërrimin e destinimit të klasës nga 1-4, por iu keni referuar nenit 6 pika 3, që flet për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore të klasës 5-6, ndërkaq toka e propozuar me iu ndërruar destinimi është e klasës 4.

Kryesuesi i Kuvendit: Të Propozim Vendimi, ka mundësi që është bërë ndonjë lëshim nga DUKMM, por ligjërisht ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore bëhet në këtë formë: me vendim paraprak të KK me vendim përfundimtar të ministrisë. Drejtori është këtu për sqarime të nevojshme.

z. Qamil Stagova: Ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore bëhet në bazë të nenin 6.2 të Udhëzimit administrativ 41/2006, ndërkaq është bërë gabim teknik në propozim vendim të baza ligjore.

z. Adnan Reka: Pasi është ashtu, atëherë ne LVV do të jemi kundër miratimit të këtij propozim vendimi. Nëse në mbledhjen vijuese na e sjell ndryshe bazën ligjore, atëherë ne mundemi edhe me ndryshuar mendimin, ndërkaq në formën siç është, ne LVV do votojmë kundër.

z. Agim Çaka: Unë po dua të konfirmoj vendimin se si do të votoj në këtë rast. Kur e kam të çartë çështjen si rastin e parë që e patëm, unë votoj për. Kur çështja është e mjegulluar, unë abstenoj, ndërkaq kur shoh se ka ndonjë shkelje në atë çështje, unë votoj kundër. Për çështjen e monitorit të cilin e potencoj Naimi, unë jam për me pasur jo një monitor, por dy, me i vendosur në dy ballinat. Për çështjet ekonomike e juridike, ne nuk jemi të fushës me i ditur se a ka shkelje apo jo. Ne duhet me iu hapur rrugë palëve për ndërrimin e destinimit, për investime të reja dhe me vazhduar tutje, por kur nuk jemi të sigurt për ligjshmëri, nuk jemi me iu hapur rrugë, duke bërë shkelje e me iu krijuar probleme edhe palës edhe komunës. Megjithatë temat duhet trajtuar mirë, se nuk guxojmë me shkuar në këtë formë me gabime teknike, se kjo të vënë në dyshim se diçka po ndodhë në këtë drejtim. Në këtë rast, unë e kam të mjegulluar çështjen dhe do të abstenoj.

Kryesuesi i Kuvendit: Për vendime të cilat merren në KK, drejtoria formon komision për trajtimin e asaj kategorie të tokës dhe jep mendimin profesional. Të vendimet paraprake nuk ka vlerësim profesional të komisionit. Komuna e jep mendimin se a ka impakt diçka apo jo në atë pronë me vendim paraprak, pastaj mendimin përfundimtar e jep ministria. Ky vendim nuk është i vlefshëm, nëse ministria nuk e jep vendimin përfundimtar. Ne e japim vendimin tonë për pjesën që na takon, se ne jemi komunë që po punojmë në zhvillimin e turizmit dhe komuna jonë e ka marrë atë formë. Ne nuk guxojmë të ngecim prapa në këtë drejtim, por t'i japim mundësi e perspektivë, ndërkaq janë njerëzit profesional në ekzekutiv dhe në ministri të cilët e japin mendimin se a duhet fuqizohet vendimi apo jo. Në rastet kur ne marrim vendim, vendimi shkon në vlerësim të ligjshmërisë dhe ka komision profesional që merret me përpilimin e propozim vendimit dhe vlerësimin e saj. Në këtë rast vlerësimin e jep ministria vendimin e përhershëm, ky vendim është për me i hapur rrugë palës për me shkuar në ministri dhe veprime të më tutjeshme.

z. Agim Mani: A ka mundësi që drejtoria përkatëse ose komisioni vlerësues me dhënë paraprakisht një pëlqim, pastaj pëlqimi me shkuar në ministri, e jo vendimin me marrë KK, sepse nëse ministria nuk e miraton, ne si KK duhet shfuqizuar të njëjtin vendim, kështu që mos të merremi dy herë me këtë çështje.

Kryesuesi i Kuvendit: Ky është vendim paraprak dhe këto vendime nuk kanë komision, Drejtoria e Urbanizmit e ka dhënë propozim vendimin, vendimin e merr ministria.

z. Agim Mani: Ne po duhet me votuar jashtëligjshëm këtë propozim vendim që nuk është në harmoni me dispozitat ligjore. Edhe nëse e ndërrojmë nenin 6 pika 6.2 përsëri është e jashtëligjshme. Cilindo variant që e përdorim si; 6.3 apo 6.2 të UA 41/2006 është e jashtëligjshme, nëse nuk epet paraprakisht pëlqimi nga ministria.

Kryesuesi i Kuvendit: Kjo procedurë është ndjekur edhe me herët, tani dhe tutje, nuk është e jashtëligjshme. Nëse juve iu pengon një gabim teknik, ajo është diçka tjetër. Unë kështu e di procedurën. Diskutime tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua me 14 votë Për (12 votat e PDK, 2 votat e AAK), Kundër ishin 8 anëtarët nga LVV, Abstenime 5 anëtarë (4 anëtarët nga LDK dhe anëtari nga NISMA). Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM PARAPRAK

Për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, PK 00824-11 ZK Strazhë, me kulturë Tokë Pyjore- Mal i Klasës 4, me sipërfaqe 637 m², pronë e Kadri (Faik) Lalinovci nga Ferizaj/ Lënda: 01Nr. 06-350/01-3225/22.

6. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, PK 01402-1 ZK Soponicë, me kulturë Bujqësore Arë e Klasës së 5, me sipërfaqen 3917m², pronë e Ekrem (Ramadan) Hyseni nga Ferizaj, nën qiramarrje 99 vjet;

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin e keni marrë, drejtori është këtu, nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Kjo tokë flitet së është privatizuar për 99 vjet. Komisioni ka dalë në vend ngjarje e ka konstatuar ndërrimin e destinimit të kësaj toke pa një ekspertizë. Shtrohet pyetja: Ne a duhet ta ruajmë tokën bujqësore apo duhet ta shkatërrojmë tokën bujqësore? Ne, të gjithë që jemi të këtij lokaliteti, e dimë se ajo tokë ka qenë tokë shumë e bujshme bujqësore, ndërkaq nuk është në rregull që për interes individual të dëmtohet interesi publik.

z. Qamil Stagova: Këtu është fjala për tokë të Fusha e Pajtimit, ku nga “Bektel Enka” ajo tokë është shfrytëzuar për deponi për kryerjen e punëve për nevoja të autostradës. Komisioni ka dalë në vendngjarje dhe sa unë kam pasur kontakte me komisionin, kanë ardhur në përfundim se ajo tokë e ka humbur karakterin bujqësore, për këtë shkak se ajo pronë është me zhavorr e gurë. Kjo është arsyeja që komisioni e ka dhënë këtë mendim, ndërkaq ju jeni ata që vendosni.

z. Naim Beça: Zhavorri dhe gurët pastrohen, një tokë që ka qenë bujqësore, si ka mundësi mos me u kthyer më në tokë bujqësore. Kjo nuk ndodhë askund në botë, kështu që përgjigja e juaj nuk me duket e logjikshme.

z. Agim Çaka: Unë po ndërlidhem me diskutimin e asaj toke bujqësore. Ajo pronë është tokë bujqësore shumë e mirë. Ne mundemi në një livadh me hedhur gurë dhe zhavorr e më

thënë se nuk mundet me e kthyer atë livadh në tokë bujqësore. Ne e dimë problematikën e asaj prone si është. Njeriu e ka marrë në shfrytëzim për 99 vjet, ndërkaq asnjëri nga ne nuk jemi në fund të këtij procesi se çka ka me ndodhur me atë pronë pas 99 vjetëve. Kjo vet si lëndë është pak e komplikuar, ajo pronë në fakt është tokë bujqësore, por arsyetimi i komisionit se i ka humbur asaj toke karakteri bujqësor, nuk është në rregull, por duhet gjetur ndonjë arsyetim tjetër, me thënë se personi e ka marrë në shfrytëzim për 99 vjet, e ka në plan me bërë një farë projekti. Është mirë me shkuar me ndonjë arsyetim me logjik, që është më i kapshëm, se ne nuk jemi që nuk marrim vesh fare në këtë punë, që në një livadh me hedhur gurë e zhavorr e me thënë se nuk mund të kthehet në gjendje të mëparshme ajo pronë. Çka nëse asaj prone ia heqim gurët e zhavorrin ? Qëllimi është tjetër, edhe kuvendi i komunës nuk ka qare pa i hapur rrugë, ndërkaq janë do gjëra që kanë ndodhur me herët, dhe ne jemi këtu me marrë vendime, nganjëherë na vjen puna me marrë edhe vendime jo të lehta e të dhimbshme. Në këtë rast unë abstenoj.

z. Adnan Reka: Për me tepër, nëse kësaj toke ia shtojmë edhe kriteret, të theksuara si në Udhëzimin Administrativ 41/2006, të marrja e lejes për ndërrimin e destinimit, neni 7 pika 1, thuhet; kërkesa për ndërrimin e destinimit të përhershëm të tokës bujqësore do të miratohet nëse përmbushën të gjitha kushtet në vijim: një prej kushteve në nenin 7.2 është bukur i gjatë, ku thuhet; nëse përmbushet kërkesa sipas paragrafit 7.1 që e potencova, ose nëse ndërrimi i destinimit të kërkuar është me interes të përgjithshëm. Interesi i përgjithshëm është kur bëjmë ndërtime për shërbime publike, e jo për interesa private. Udhëzimi administrativ është bukur i qartë, megjithatë ju i keni shumicën, vendosni.

Kryesuesi i Kuvendit: Nuk është vetëm çështja e shumicës me i debatuar dhe diskutuar çështjet, meqë ajo pronë dhe shumë prona tjera janë tokë bujqësore, se atypari kalojmë gati çdo ditë. E dimë edhe faktin tjetër se komuna e Kaçanikut pjesën me të madhe të zhvillimit ekonomik, qoftë nga veprimtaria prodhuese apo nga ato tregtare e ka orientuar në atë pjesë. Bile një pjesë e asaj prone është shpallë zonë ekonomike, kështu që është e arsyeshme që ne t'iu japim mundësi njerëzve që të punojnë, të zhvillojnë dhe ndërtojnë edhe biznesin e tyre, por krahas asaj edhe zhvillimin e komunës tonë. Është mirë drejtor që këto gjëra të trajtohen me PZHK të ri i cili është në hartim e sipër. Ka kërkesa të shumta edhe prej qytetarëve që pjesët e tokave që janë skaj magjistraleve, Ferizaj-Kaçanik të përfshihen në PZHK, të futen si zona ekonomike për zhvillim, sepse nuk kemi ndonjë mundësi tjetër për me u shtrirë bizneset në komunën tonë. T'iu japim mundësi njerëzve që më mos t'i ndjekin këto procedura-kërkesa për ndërrim destinimit të tokave, por të aplikojnë direkt të drejtoria. Në momentin që ato pjesë bëhen zona ekonomike, vetëm i paguajnë taksat që iu përkasin dhe të kryejnë punë, sepse vërtetë janë procedura të cilat po iu zgjasin njerëzve, sidomos për pronat nga 1-4, procedura në ministri. Të jeni të bindur që ajo pjesë nga Fusha e Pajtimit e deri të Pishina tani veç e ka marrë trajtën e zonës ekonomike. Por jo vetëm ajo pjesë, por edhe pjesa tjetër rreth magjistrals duhet ta merr të njëjtën formë, për arsye se bizneset janë orientuar në atë pjesë. Ka numër të madh të papunësuarve, ka numër të madh të bizneseve, kështu që t'iu hapim rrugë njerëzve për të punuar. Ai e ka privatizuar këtë pronë për 99 vjet, dhe në momentin kur e ka privatizuar, ai është dashur me i pasur do kriteret se për çka ka me shfrytëzuar atë pronë. Nëse është në kundërshtim me atë për çka e ka privatizuar, ata nuk e lënë, kështu që mos të jemi ne ajo pengesa, por ai e ka edhe një vend tjetër ku duhet me kërkuar për atë pronë dhe nëse atij i lejohet ndërtimi në ato kriteret në atë pronë, që ne nuk po i dimë, atëherë mos të jemi ne pengesë për mos me i lejuar me u zhvilluar. Ky është mendimi im, mund të jem edhe gabim, sepse e di rëndësinë e atij vendi dhe numrin e punëtorëve që janë të punësuar në atë tokë. Ky është vlerësimi im personal.

z. Rrustem Zenuni: Unë vetëm desha me potencuar, mbaj mend debatet e kandidatëve për kryetar në vitin 2017, ku kandidatët e opozitës për këtë zonë ku po flitet me iu ndërruar destinimi, kanë pas dhënë premtim që në rast se fitojnë kanë me bërë deponi të mallrave, ku ajo pjesë shkarkohen për shkak të kyçje ç kyçje së autostradës, e pastaj prej deponisë që ndërtohet aty shpërndahen produktet, destinimi i produkteve. Kështu që, unë nuk e shoh shumë problematike këtë ndërrim destinimi, së zona me e zhvilluar ekonomike është Fusha e Pajtimit- Doganaj, Elezaj, kështu që kjo kishte me i kontribuar -me i dhënë një hov, jo vetëm kjo por mund të vijë edhe propozime tjera për atë pjesë, kështu që ne duhet me shfrytëzuar edhe kyçje e autostradës edhe gatishmërinë e njerëzve që donë me investuar me zhvilluar komunën tonë. Unë jam për, besoj që edhe grupi parlamentar i PDK edhe anëtarët tjerët duhet të përkrahin çështjet që është në interes të komunës.

z. Besnik Salihu: Desha me pyetur drejtorin, nëse ka për këtë tokë ndonjë proces gjyqësor në gjykatën e Kaçanikut. A janë në dijeni se kjo tokë thuhet së është tokë e Matlumëve. Nëse kjo pronë është në kontest gjyqësor, ndërkaq ne me marrë një vendim për me ia lejuar dikujt me bërë biznes, nuk kishim me dal mirë para matlumëve, pa u marrë vendimi nga gjykata.

z. Qamil Stagova: Nuk kemi ndonjë kufizim prej gjykatës, në mënyrë zyrtare nuk kemi njohuri në këtë drejtim.

Kryesuesi i Kuvendit: Kryesisht rastet kur ka konteste gjyqësore, gjykatat vendosin masa kufizuese. Në momentin që vendosët masa kufizuese, njoftohet zyrtarisht edhe komuna dhe pezullohen të gjitha procedurat. Unë nuk e di, por drejtori po thotë se nuk ka njohuri për ndonjë masë kufizuese për atë pjesë, atëherë kjo duhet mbetet ashtu siç është. Diskutime tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua me 14 votë Për (12 votat e PDK, 2 votat e AAK), Kundër ishte 1 anëtar nga LVV Raif Kasa, Abstenime 12 votë (7anëtarë nga LVV, 4 anëtarët nga LDK dhe anëtarë nga NISMA). Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, parcela kadastrale 01402-1 zona kadastrale Soponicë, me kulturë Bujqësore Arë e Klasës së 5, në vendin e quajtur MATLUMA-SALLAISHTA me sipërfaqen 3917m², pronë e Ekrem (Ramadan) Hyseni nga Ferizaj, nën qiramarrje 99 vjet / Lënda: 01Nr. 06-350/02-7606/22.

Kryesuesi i kuvendit: Ne po mendojmë që jemi në rregull për këto vendime. Të gjitha vendimet shkojnë në shqyrtim të ligjshmërisë. Ka ndodhur me na u kthyer për rishqyrtim ndonjë vendim. Në momentin që na kthehet ndonjë prej këtyre vendimeve, i marrim veprimet e nevojshme dhe e shfuqizojmë. Kalojmë në pikën vijuese:

7. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, PK 00311-0 ZK Ivajë, me kulturë Bujqësore Livadh i Klasës së 6, në sipërfaqen 300m², pronë e Samedin (Vehbi) Rexha nga Kaçaniku;

Materialin e keni marrë, nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

z. Agim Mani: DUKMM iu ka referuar ligjit me Nr. 04/L-173, paragrafi 5 i nenit 1.2. ky paragraf i këtij neni thotë: Planifikimi i nivelit lokal në territorin e komunës përmes dokumenteve të planifikimit hapësinor janë: plani zhvillimor, hartimi zonal i komunës, plani rregullativ i komunës. Në bazë të cilit dokument është bërë ky propozim vendim ? Tjetër, kërkesën parashtruesi e ka bërë për 300m², komisioni ia ka aprovuar për 250m². Ndoshta

është një gabim teknik ku shënohet se është përpiluar me 07.05.2022, kurse parashtuesi i kërkesës është 14.03.2022. Unë po shoh shumë gabime këtu dhe nuk do të bëhem pjesë e këtij vendimi. Me 07.04.2021 është iniciuar procedura, d.m.th para një viti. Ka disharmoni në mes të procesverbalit të komisionit dhe propozim vendimit për sipërfaqen e cila do t'i ndërrohet destinimi. Cilës me i besuar, vlerësimi të komisionit për 250m² apo propozim vendimit të DUKMM për 300m². Lista e distribuimit është protokolluar me 12.03.2022, adresuar komisionit prej 3 anëtarëve (Mustafë Loku, Arditë Shehu dhe Rakip Vishi).

z. Qamil Stagnova: Të datat mund janë bërë gabime teknike.

Kryesuesi i Kuvendit: Ka mundësi të jenë bërë gabime teknike në data.

z. Rrustem Zenuni: Pasi që janë bërë gabime teknike të datat, kisha kërkuar që të heqim nga rendi i punës këtë pikë dhe e njëjta të shqyrtohet në mbledhjen vijuese të KK pas përmirësimeve të gabimeve teknike.

Kryesuesi i Kuvendit: Sa ka arsye që për gabime teknike të datave t'ia zvarrisim procedurën palës?

znj. Ardita Rrahmani: Desha me u ndërlidhur me parafolësin, që mos të krijojmë standard të dyfishtë. Në pak me herët në këtë mbledhje e patëm një çështje me gabime teknike dhe e njëjta u votua. Pak rëndësi është personi që e ka bërë kërkesë, ne si KK duhet të jemi për të gjithë të njëjtë.

z. Agim Çaka: Këtu po shihet qartë se ka gabime teknike, në fillim është data 07.04.2021, pastaj më poshtë është procesverbali i përpiluar me 07.05.2022. Unë nuk jam me vonuar palën për lëshime të gabimeve teknike. E potencova edhe me herët, mos lejoni me u bërë kësaj lloji gabimesh se vetëm sa po na marrin kohë, ndërkaq gabimet teknike pavarësisht sa janë të vogla, mund t'na kushtojnë dhe nuk është mirë me i kaluar çështjet me gabime teknike, kur dihet se këtu mbahet procesverbal, shënohen diskutimet e secilit që merr fjalë, shënohen këto vërejtjet që janë hasur. Këtu mundemi me u kuptuar për do gabime që po shihen qartë, por mund të kemi edhe çështje që nuk mund të dimë se a janë gabime teknike apo janë bërë me qëllime të caktuara. Këto është mirë mos me u përsëritur në mbledhjen vijuese, sepse na marrin kohë pa lidhje.

z. Agim Mani: Të kjo çështje, ne po bëmë ndeshë me vlerësimin e komisionit dhe propozim vendimin e drejtorisë. Në propozim vendim është propozuar me iu ndërruar destinimi 300m², ndërkaq vlerësimi i komisionit është për 250m².

z. Qamil Stagnova: Komisioni ka dalë në vendngjarje dhe e ka dhënë vlerësimin për 250m².

Kryesuesi i Kuvendit: Pse është bërë atëherë propozim vendimi i drejtorisë për 300m²? Meqë edhe drejtori i DUKMM po kërkon me tërheqë propozim vendimin në mënyrë që të përmirësoj, sepse gabimet teknike të datat mund të arsyetohen diqysh, ndërkaq gabimet teknike të sipërfaqeve në m², ne nuk e dimë pse komisioni ka vlerësuar për 250m², ndërkaq propozim vendimi i drejtorisë është bërë për 300m². A jeni që të tërhiqet ky propozim vendim?

znj. Ardita Rrahmani: Gabimi me trashanik (baza juridike) ishte të Propozim Vendimi paraprak për ndërrim destinimi të tokës bujqësore të Kadri Lalinovci nga Ferizaj dhe u votua kjo çështje, ndërkaq të kjo lëndë me u tërhequr për gabime të lëshuara teknike, pavarësisht e kujt është prona, në këtë rast kujtoj se po krijohet standard i dyfishtë.

Kryesuesi i Kuvendit: Qysh po mendoni ju që është gabimi i njëjtë, gabimi i një neni në propozim vendim, apo kur është gabuar sipërfaqe të metrave katror ?

znj. Ardita Rrahmani: Gabimi me trashanik kryesues është me gabuar nenin.

z. Selajdin Troni: Edhe unë jam për me tërheq këtë propozim vendim, dhe e njëjta të shqyrtohet pasi të rregullohen gabimet e lëshuara teknike.

Kryesuesi i Kuvendit: A jeni për me tërhequr këtë pikë, dhe të rregullohen gabimet teknike ?

z. Adnan Reka: Kërkoj 1 -2 minutë pushim për konsultime, sepse nuk jemi duke ditur as ne si me vendosur. Ne i patëm mendimet e tona, meqë u krijuar kjo situatë tani kështu, nuk po dimë si me vendosur, se duhet me u konsultuar me opozitën që thanë për vendimin paraprak se kaloj me gabime.

Kryesuesi i Kuvendit: Çështja sesi me vendosur, nuk kemi ne mendim kolektiv këtu, është e drejtë e secilit me pasur mendimin e vet, është e drejtë edhe e drejtorit me kërkuar me tërhequr pikën.

z. Agim Çaka: Unë nuk kam nevojë për pauzë për me humbur kohë. Vendimet janë individuale të secilit nuk janë në paketë, është e drejtë e secilit sesi voton. Por çështja është, mos t' na kalon kjo çështje në praktikë që me vendosur për standarde të dyfishta. Për një çështje me kaluar pavarësisht gabimeve teknike e tjetra jo. Kishte me qenë mirë kjo pikë me u tërhequr për me u përmirësuar e me sjellë në mbledhjen vijuese, prona është private dhe me ecur lënda.

z. Betim Shala: Unë nuk e di si po i vlerësoni çështje e gabimeve teknike, cila ka më shumë gabime teknike e cila me pak. Ajo e Lalinovcit kaloj, kur shumica ishin me hequr nga rendi i punës, kjo po me duket mua me tepër çështje politike. Unë mendoj që kjo pikë duhet me dalë në votim.

Kryesuesi i Kuvendit: Mendimi është individual i secilit, kjo ka me dal në votim o me votuar apo me hequr. Drejtori kërkoj me tërhequr këtë pikë.

z. Besnik Salihu: Me tërhequr këtë pikë e propozoj anëtarin nga PDK, Rustem Zenuni.

Kryesuesi i Kuvendit: I keni 2 minuta pauzë për konsultime, pastaj vazhdojmë.

Pas pauzës, kryesuesi i kuvendit konstatojmë me vazhduar punimet e mbledhjes aty ku mbetem. Ishte propozimi me hequr këtë pikë apo me vazhduar. A ka kush ndonjë diskutim për këtë pikë ? Diskutime tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim këtë pikë me e tërhequr dhe e njëjta të korrigjohet. Rezultati i votimit ishte 13 votë Për (11 anëtarë nga PDK, 2 anëtarët nga AAK), 13 votë Kundër (8 anëtarët nga LVV, 4 anëtarët nga LDK dhe anëtarin Kadri Krivenjeva nga PDK). Abstenoj anëtarin nga NISMA, Agim Çaka. Atëherë meqë numri i votave Për dhe Kundër mbetet i barabartë, kryesuesi i kuvendit e shfrytëzoj të drejtën e përdorës së votës së dyfishtë Për. Në sajë të kësaj del konstatimi së me votën e dyfishtë të Kryesuesit të Kuvendit, Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Shtyrjen e Propozim Vendimit 01Nr. 06-350/01-6286/22 -për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore në emër të Samedin Rexha, për mbledhjen tjetër për shkak të gabimeve teknike/ lënda: 01nr. 06-350/01-6286/22.

Nga Sekretaria e KK mbetet obligim të konsultoj me MAPL, a është në rregull përdorimi i votës së dyfishtë të Kryesuesit të KK në këtë rast. Nëse është në rregull kalohet, nëse jo atëherë mbetet pezull kjo lëndë dhe e shqyrtojmë në mbledhjen vijuese të KK.

8. Propozim Vendimi për emërimin e komisionit përzgjedhës për drejtor të institucioneve arsimore;

Kryesuesi i Kuvendit: Drejtori është këtu prezent, kjo praktikë është nga viti i kaluar. Sipas disa UA të reja, kërkohet që anëtarët e komisionit për zgjedhjen e drejtorëve të shkollave të votohen në KK. Për sqarime të nevojshme jep drejtori. E hapi diskutimin e kësaj pike:

znj. Kadrije Lika-Troni: Të Udhëzimit Administrativ(UA) 151/2020, neni 6 pika 3 komisioni përzgjedhës për institucionin arsimor që janë në varësi të komunës ka këtë përbërje; 2 anëtarë të komunës të cilët propozohen nga drejtoria e arsimit dhe miratohen nga KK. Anëtari i parë është i punësuar në drejtori, ndërsa anëtari i dytë i propozuar nga drejtoria e arsimit, është njëri nga këta 3; ekspert i pavarur i arsimit, drejtor i institucionit arsimor me përformancë të lartë; përfaqësues nga këshilli i prindërve në nivel komune me kualifikim dhe ekspertizë në fushën e edukimit. Desha me pyetur: A është kjo përfshirje e drejtë, ku UA e jep të jetë drejtor e jo zëvendësdrejtor?

z. Zahir Doda: Kategoria e drejtorit dhe zëvendësdrejtorit janë të barabarta. Edhe procedura për përzgjedhje është e njëjtë, kështu që është në rregull kjo. Kategorinë 1 dhe 3 e kemi problem me gjetur anëtarë, gati është e pamundur, të kategoria 3 sepse është e pamundur me gjetur se nuk kemi të nivelit të kërkuar. Jam munduar me përfaqësuar edhe gjininë femërore se MASH kërkon përfaqësimin edhe të femrave.

znj. Kadrije Lika-Troni: Nuk kam asgjë personale me kandidaten e propozuar. Unë mendoj se ka pasur mundësi me qenë një përfaqësues i prindërve të nivelit të lartë, mirëpo përderisa po kërkohet aty pozitivë drejtori, anëtari zëvendësdrejtor në UA nuk ceket që mundet me qenë anëtar, nëse nuk ka drejtor.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua me 15 votë Për (12 votat nga PDK, 2 votat nga AAK dhe anëtari nga NISMA), Kundër janë 3 anëtarë nga LDK, Abstenuan 9 anëtarë (8 anëtarët nga LVV dhe Arlinda Rakoci-Raka nga LDK). Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori:

VENDIM

Për emërimin e komisionit përzgjedhës për drejtor të institucioneve arsimore në përbërje:

- 1. Hajrush Dullovi, kryetar i komisionit, zyrtar i lartë i arsimit;**
- 2. Arlinda Elezi, anëtare, zëvendësdrejtoreshë në SHFMU "Emin Duraku"; dhe**
- 3. Një(1) përfaqësues i MASH-it, anëtar.**

Dy përfaqësues të Këshillit drejtues nga IEAAP, në cilësinë e vëzhguesve, një prind dhe një mësimdhënës. Lënda: 01Nr. 104/02-10290/22.

9. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore PK 01123-6 ZK Kaçanik i Vjetër, me kulturë bujqësore Arë e Klasës 6, me sipërfaqe 600 m², pronë e KBI;

Kryesuesi i Kuvendit: Këtu kemi të bëjmë me ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore të kërkuar nga Bashkësia Islame-BI, drejtori është këtu, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Betim Shala: Ne LDK, propozim vendimet për ndërrimin e destinimit të tokave bujqësore zakonisht i kemi votuar Për, përpos precedentit që u krijua këtu, që për dike po bënë për dike jo. Atëherë, prej këtij momenti për ndërrimet e destinimeve të tokave, ne LDK do të votojmë Kundër, përderisa nuk sqarohet se çka parashihet me PZHK në ato prona, se nuk është paraqitur, e që është e domosdoshme me u paraqitur.

Kryesuesi i Kuvendit: A është me PZHK ju e dini me mirë, se keni punuar në PZHK. Arsyetimi se deri dje i keni votuar Për, ndërrimet e destinimeve e sot jo, nuk qëndrojnë, e keni gabim sepse nëse është dashur, është dashur edhe me herët me i shikuar çështjet tjera që i keni votuar, se a janë me PZHK.

z. Betim Shala: Unë çdo herë kam kërkuar se a janë me PZHK pronat e kërkuara me iu ndërruar destinimi, por ju me keni thënë se ju i dini më mirë. Kryesues, unë në pozitën që jam, nuk jam me i shpjeguar se qysh janë pronat me PZHK, që po me thoni se keni punuar në atë sektor dhe i dinë me mirë se ne, qysh janë pronat me PZHK.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua me 16 votë Për (12 votat e PDK, 2 votat të AAK, 1 votë nga LVV Bashkim Luma dhe vota e anëtarit nga NISMA Agim Çaka), Kundër ishin 4 anëtarët nga LDK Abstenime 7anëtarë nga LVV. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore PK 01123-6 ZK Kaçanik i Vjetër, me kulturë bujqësore Arë e Klasës 6, me sipërfaqe 600 m², pronë e Këshillit të Bashkësisë Islame-KBI/ Lënda: 01Nr. 06-350/01-2433/2022.

10. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore PK 0001952-0 ZK Kaçanik, me kulturë bujqësore Arë e Klasës 6, me sipërfaqe 600 m², pronë e KBI;

Kryesuesi i Kuvendit: Propozim vendimin e keni marrë, drejtori është këtu, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

znj. Ardita Rrahmani: Unë po e arsyetoj pse do të votoj kundër këtij propozim vendimi. Në mbledhjen e KPF, znj. Kadrije Lika- Troni e ka dhënë arsyetimin e saj se nuk i kemi të qartë sa duhet këtë çështje. Bëhet fjalë për objektin e xhamisë e cila është ndërtuar në Dushkajë. Ka dy vite që punohet në atë xhami, gati se kanë përfunduar punimet, kurse KBI pas dy viteve ka filluar me procedura. Kjo nuk është një praktikë e mirë kujtoj unë, e sidomos kur çështja vjen nga KBI. Nuk jemi kundër ndërtimit të objektit të xhamisë, se kryesuesi në mbledhjen e KPF 2-3 herë me u drejtua se a ta prishim xhaminë. Nuk jemi për me prishur objektin fetar-xhami, por jemi për me i ndjekur procedurat, ndërkaq inspektorët të cilët paguhen me taksat tona, të jenë me vigjilentë në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi për të cilat ata janë të thirrur.

Kryesuesi i Kuvendit: Ne e diskutuam këtë çështje në KPF dhe çështja që ju kam drejtuar juve, po mundohesh me mi interpretuar, por unë nuk iu thashë në formë shumë zyrtare. Secili e ka mendimin e vet si diskuton dhe si voton. Edhe pse BIK është institucion, duhet respektuar procedurat, megjithatë objekti është ndërtuar, ne duhet vendosim tani.

z. Agim Çaka: Edhe unë pajtohem me znj. Ardita për përfillje të procedurave, sepse ndodhë që objekti është ndërtuar para 2 viteve në kohën e legjislaturës së kaluar, ndërkaq ne tani me marrë ato përgjegjësi. Ne nganjëherë po bëmë në pozitë të keqe, si në këtë rast, sikur me qenë kundër Bashkësisë Islame, e me u bërë kjo çështje temë e diskutimit në opinion. Ne nuk jemi kundër xhamisë, as kundër BIK, se kjo mund të keqpërdoret, por jemi kundër asaj se nuk janë zhvilluar procedurat paraprake. Drejtor, komisionet dhe inspektoratet të jemi me të vëmendshëm për përgjegjësitë e tyre. Ne jemi anëtarë të KK, kemi ardhur me votën e qytetarëve këtu, me kryer punë në interes të komunës dhe të qytetarëve. Secili anëtar i KK e ka peshën dhe rëndësinë e vet, e ka mendimin e vet sesi voton. Edhe unë jam me mendimin e Areditës për respektim të procedurave, që mos të na vjen puna për shkak të mospërfilljes së procedurave, mos me votuar një vendim të arsyeshëm, sikurse ishte rasti i një vendimi në mbledhjen e kaluar.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka, atëherë e shtrojmë në votim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua me 16 votë Për (12 votat e PDK, 2 votat e AAK, 1 votë nga LVV Bashkim Luma dhe vota e anëtarit nga NISMA Agim Çaka), Kundër ishin 4 anëtarët nga LDK Abstenime 7 anëtarë nga LVV. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore PK 0001952-0 ZK Kaçanik, me kulturë bujqësore Arë e Klasës 6, me sipërfaqe 600 m², pronë e Këshillit të Bashkësisë Islame- KBI / Lënda: 01Nr. 06-350/02-10174/22.

11. Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private ZK Begracë, 17 parcela të evidentuara në emër të N.P.P.T.T.SH. ALK-OIL me nr. të biznesit 70052105;

Kryesuesi i Kuvendit: Propozim vendimin e keni marrë, drejtori është këtu, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Rruga e cila kërkohet me u këmbyer pronat- rruga e cila shkon përmes, a i lidhë lokacionet-tokat tjera apo është vetëm pronë e këtij shfrytëzuesi dhe a kanë kyçje lokacionet tjera në këtë rrugë ?

z. Qamil Stagnova: Rruga që shkon midis pronave vazhdon dhe lidhet me rrugën Gërlicë-Viti, është rrugë që e ka hapur firma ALK-OIL. Kjo rrugë është rrugë publike që mundet me shfrytëzuar edhe ndokush tjetër për shfrytëzim të pompës, për këtë arsye është menduar që kjo rrugë mos me qenë në mes, por me u bërë anash paralel me rrugën kryesore dhe me u hequr rruga në mes, duke marrë parasysh veprimtaritë janë të rrezikshme, e kemi parë të arsyeshme me u bërë kjo rrugë. Rruga tjetër është malore e cila rrugë shumë pak shfrytëzohet, dhe ajo rrugë shkon për skaj të pronës së kësaj.

z. Agim Mani: Drejtor, këtu për shkak të interesit individual, po dëmtohen interesi publik. Kjo rrugë është afër hekurudhës dhe nuk ka shumë hapësirë me qenë e kalueshme, kur dihet se hekurudha nuk lejon me iu afruar afër me rrugë. A është shqyrtuar ndonjë alternativë tjetër, se ky po e shfrytëzon rrugën publike për interes personal. Pronari duhet me pasur pëlqim të pronave që preken me këtë këmbim.

z. Qamil Stagnova: Rrugën publike e zgjeron, se ai edhe aty e lëshon një pjesë të tij, ndërkaq pronat janë të njëjtës ndërmarrje.

z. Agim Mani: Atëherë pa e dëmtuar interesin e përgjithshëm, ai ka pasur mundësi me bërë kyçje në rrugën, e mos me kërkuar fare këmbim të pronave, se nuk ka pasur nevojë me këmbyer prona.

z. Agim Çaka: Kur nuk i kemi gjërat e qarta sa duhet, duhet me qenë të kujdesshëm kur japim prona të komunës, se kujt po ia japim dhe si po ia japim. Ne këto raste duhet me qenë të kujdesshëm, mos me dëmtuar as interesin e komunës e as të kompaninë që ka investuar aty. Ne jemi me i mbrojtur interesat e komunës, kështu që duhet pasur kujdes në marrjen e vendimeve të tilla.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua me 14 votë Për (12 votat e PDK, 2 votat e AAK), Kundër ishin 4 anëtarët nga LDK Abstenime 9 anëtarë (8 anëtarët nga LVV dhe anëtari nga NISMA). Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private ZK Begracë, 17 parcela me nr. parcelat me nr.: 1244-0 1247-0, 1248-0, 1251-0, 1252-0, 1257-0, 1258-0, 1300-0, 1260-0, 1259-0, 1254-0, 1256-0, 1253-0, 1250-0, 1249-0, 1246-0 1245-0, me sipërfaqe të përgjithshme 00.11.18 ha, zona kadastrale Begracë, e evidentuar në emër N.P.P.T.T.SH.ALK-OIL me nr. të biznesit 70052105; Në KËMBIM me Pronën e paluajtshme në pronësi të komunës së Kaçanikut, pjesët e parcelave me nr. 001261-0, 001265-0 dhe 001626-0 me sipërfaqe 00.11.40 ha, zona kadastrale Begracë / Lënda: 01Nr.06-841/01-7951/22.

12. Propozim Vendimi për shfuqizimin e vendimit 01Nr. 327/09 - për bartjen (delegimin) e kompetencës;

Kryesuesi i Kuvendit: Këtë propozim vendim e ka propozuar unë, ka ekzistuar një vendim i vitit 2009 i KK, sipas të cilës kuvendi ia ka bartur kompetencat KPF për ndërrimin e destinimit të tokave bujqësore të klasës 5 dhe 6. Atëherë është thënë se ka qenë shumë i arsyeshëm, sepse ka pasur shumë kërkesa për ndërrim destinimi, vendimi ka qenë për sipërfaqe të vogla, megjithatë tani po përballemi si KPF edhe më ndërrim destinimi të sipërfaqeve të mëdha, kështu që e kam sjellë në KK me tërheqë KK këtë kompetencë, dhe KK të merret edhe më këtë ndërrim destinimi. Një prej arsyeve ka qenë se vendimet e KPF nuk shqyrtohen vlerësimi i ligjshmërisë, edhe atëherë nuk ka qenë shumë i arsyeshëm, dhe tani e kam sjellë në KK. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua me njëzëri me 27 votë. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për shfuqizimin e vendimit 01Nr. 327/09 të datës 30.01.2009- për bartjen (delegimin) e kompetencës, Komitetit për Politikë dhe Financa, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të sipërfaqeve të vogla të klasës 5 dhe 6 / Lënda: 01Nr. 104/02-11076/22.

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, kështu që Kryesuesi i Kuvendit Kemal Murseli e konstatoj mbledhjen e përfunduar në ora 12:53 Deri në fund të mbledhjes ishin të gjithë anëtarët e KK.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

LISTË DISTRIBUIMI / CIRKULARNO PISMO / ROUTING SLIP

REFERENCË	09-104/02-13257/22
PËR/ZA/TO:	Zyren e Kuvendit Komunal z. Kemal Murseli- Kryesues i Kuvendit
Kopje:	z. Besim Ilazi- Kryetar i Komunës
NGA/ OD/ FROM:	Znj. Hafize Sallahi- drejtoreshë e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	DRAFT RREGULLORE PËR MËNYRËN DHE KUSHTET E SHFRYTËZIMIT TË PALESTRËS SPORTIVE NË KOMUNËN E KAÇANIKUT
DATË/E	

I nderuar,

Bashkë me këtë shkresë zyrtare ju dërgoj kopjen e DRAFT RREGULLORES, PËR MËNYRËN DHE KUSHTET E SHFRYTËZIMIT TË PALESTRËS SPORTIVE NË KOMUNËN E KAÇANIKUT, për procedim të mëtuqjeshëm si pikë e rendit të ditës në mbledhjen e radhës së Kuvendit Komunal.

Me respekt.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik/Municipality of Kačanik



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



01Nr.
Kačanik, datë

I	Data	17.05.22	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.	Numri	Shtojcë		
09	104/02-13257.1			

DRAFT RREGULLORE NR.03/2022

**PËR MËNYRËN DHE KUSHTET E SHFRYTËZIMIT TË
PALESTRËS SPORTIVE NË KOMUNËN E KAÇANIKUT**

Kaçanik, mars 2022

Në mbështetje të nenin 11 dhe nenit 12 paragrafi 2, pika (c), si dhe nenit 58 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040; nenit 34 paragrafi 5, si dhe nenit 73 të Statutit të Komunës së Kaçanikut (Teksti i spastruar sipas Statutit 01.Nr.60/01-12895/20-për Ndryshimin dhe Plotësimin e Statutit të Komunës së Kaçanikut 01.Nr.3588/2008 të datës 25/08/2008), Kuvendi i Komunës së Kaçanikut, në mbledhjen e mbajtur më: , Miratoj këtë:

RREGULLORE

PËR MËNYRËN DHE KUSHTET E SHFRYTËZIMIT TË PALESTRËS SPORTIVE NË KOMUNËN E KAÇANIKUT

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Me këtë Rregullore përcaktohen mënyrat dhe kushtet e shfrytëzimit të Palestrës së Sporteve, aktivitetet sportive të klubeve të regjistruara në Federatat gjegjëse, manifestimeve të ndryshme të kulturës, tubimeve partiake, revistave, rekreacionit si dhe grupeve të tjera joformale.

Neni 2

Përkufizimet

1. DKRS – Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
2. Objekt sportiv-nënkupton, objektin ku ndodhen zhveshtoret, hapësirat teknike dhe logjistike, dhe fushat sportive m'brenda dhe jashte palestre me të gjitha pajisjet tjera mbështetëse.
3. Menaxher - personi zyrtar që kujdeset për planifikim dhe organizim të punëve, koordinim me klubet, komunikim me strukturat e Komunës, kontrollin e stafit, raportimin e punës, etj.

Neni 3

Funksionimi i Palestrës Sportive

1. Funksioni primar i palestrës sportive është që të krijoj kushte për zhvillimin e aktiviteteve sportive, rekreative, koncerte, tubime dhe ngjarje tjera të organizuara.
2. Në palestër mund të zhvillohen ndeshje dhe stërvitje të sporteve të cilat janë të përshtatshme vetëm për ambiente të mbyllura si: Basketboll, Hendbol, Volejbol, Futsall dhe sporte tjera të licencuara sipas federatave përkatëse.
3. Në palestër mund të zhvillohen aktivitete tjera sportive të cilat vlerësohen si jo të rrezikshme për dëmtimin e dyshemesë dhe ambienteve tjera.
4. Në palestër mund të zhvillohen aktivitete promovuese kulturore, sportive, ekonomike, tubimet nga fushat politike etj. .

Neni 4

Mirëmbajtja dhe Investimet Kapitale

1. Të hyrat që gjenerohen nga aktivitetet në palestër do të derdhen në llogarinë bankare të Komunës së Kaçanikut.
2. Menaxhmenti i objektit obligohet të njoftoj DKRS-në për qdo prishje, demolim dhe për qdo intervenim tjetër me anë të kërkesës.
3. DKRS e shqyrton kërkesën e parashtruar për intervenim në mirëmbajtje, e rekomandon te Kryetari i Komunës për aprovim.
4. Investimet kapitale të nevojshme në objektin sportiv realizohen nga buxheti i Komunës së Kaçanikut.
5. Nevojat për investimet përcaktohen nga DKRS-ja dhe aprovohen nga Kryetari i Komunës.

Neni 5

E drejta për shfrytëzimin e Palestrës sportive

Të drejtën e shfrytëzimit të palestrës sportive e kanë: Institucionet shtetërore, klubet sportive, organizatat politike, organizatat joqeveritare, bizneset, institucionet shkollore, Universitetet, institucionet ndërkombëtare si dhe grupe tjera formale dhe joformale.

Neni 6

Mënyra e shfrytëzimit të Palestrës sportive

Mënyra e shfrytëzimit të palestrës sportive rregullohet me anë të marrëveshjes së arritur të palës së interesuar me menaxherin e objektit të palestrës sportive, e cila nënshkruhet nga menaxheri i palestrës dhe palës së interesuar.

Neni 7

Kërkesa për shfrytëzim

1. Pala e interesuar për shfrytëzim të palestrës duhet të paraqesë kërkesë së paku 3(tri)ditë pune para mbajtjes së aktivitetit, dhe me kohë të dorzoj edhe shkresën me të cilën dëshmon për njoftimin e aktivitetit në organet përgjegjëse të sigurisë (Polici , kompani të sigurimit etj...)
2. Kërkesa i drejtohet me shkrim DKRS, i cili obligohet për të kthyer përgjigje me shkrim brenda 24 orëve.
3. Klubet sportive të komunës së Kaçanikut të cilat janë të licencuara në Federatat gjegjëse që kanë kalendarin e rregullt të garave nuk i nënshtrohen paragrafit 2.
4. Udhëheqësit e klubeve sipas paragrafit 3 të këtij neni obligohen që për çdo fillim të vitit në muajin Janar ti prezantojnë përgjegjësit të palestrës orarin e aktiviteteve të veta.

Neni 8

Orari i shfrytëzimit të hapësirës së palestrës

1. 1. Objekti sportiv është në funksion 7 ditë në javë duke filluar nga ora 8:00h-23:00h.

2. Orari i rregullt i punës është nga dita e hënë deri të premten nga ora 8:00h -23:00h.
3. Oraret tjera që nuk përkojnë me pikën 2 të këtij neni duhet të rezervohen me kërkesa të posaçme siç është cekur në nenin 7 të kësaj Rregullore.
4. Për lokalet që janë në kuadër të palestrës sportive do të zhvillohet procedurë për dhënie në shfrytëzim sipas Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 9

Rregullat themelore për shfrytëzimin e palestrës sportive (rendi shtëpiak)

1. Për pakënaqësitë eventuale ,shfrytëzuesi duhet të drejtohet me ankesë në DKRS.
2. Menaxheri i palestrës ka të drejtë të suspendoj përkohësisht shfrytëzuesin e sallës për mos respektimin e kriterëve të përcaktuara në marrëveshje dhe rregullave sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje deri në vendimin tjetër të DKRS-së.
3. Shfrytëzuesi i palestrës duhet të identifikohet dhe të regjistrohet çdo herë para shfrytëzimit të palestrës dhe të respektojë orarin e caktuar në marrëveshje me personat përgjegjës në palestër.
4. Ndalohet pirja e duhanit në të gjitha hapësirat brenda palestrës.
5. Pas shfrytëzimit të hapësirave në palestër dhe zhveshtoreve, kujdestarët kontrollojnë hapësirat për të verifikuar gjendjen.
6. Klubet dhe individët duhet vet të kujdesen për gjërat e tyre personale,ndërsa menaxhmenti në palestër nuk mban përgjegjësi për gjërat e humbura apo të dëmtuara.
7. Shfrytëzimi i palestrës bëhet me pagesë sipas tarifës së caktuar me këtë rregullore ndërsa përjashtim bëjnë vetëm subjektet e lira.
8. Pajisjet që përdoren në palestër nga sportistët duhet të jenë të përshtatshme me ambientin e palestrës. Përjashtohen rastet kur ka ndonjë marrëveshje të posaçme me DKRS-në.
9. Ndalohet hyrja në parket me këpucë të papastra që lënë gjurmë.
10. Shitja e rekuizitave, pijeve, ushqimeve dhe gjërave tjera në objektin sportiv është e ndaluar.
11. Klubet sportive duhet të sjellin orarin e tyre për shfrytëzimin e palestrës te menaxheri i palestrës.
12. Fëmijët nën moshën 16 vjeçare duhet të jenë nën përcjellje të prindit apo kujdestarit të tyre (gjatë stërvitjeve por edhe gjatë përcjelljes së ndeshjeve si shikues)
13. Ndalohet hyrja me kafshë në palestër, ndërsa përjashtohet rasti kur kafsha i ndihmon personit me aftësi të kufizuara.
14. Në zhveshtore nuk lejohet asnjë lloj i pijeve alkoolike, pijeve me ambalazh qelqi, ndërsa lejohen vetëm pijet freskuese të lojës.
15. Ndalohet hyrja në palestër me bicikleta,skateboard apo qfarëdo mjeti tjetër transportues, përjashtimisht personat me aftësi të kufizuara.
16. Ndalohet hyrja me armë, përpos personave të autorizuar të sigurisë në detyrë.
17. Ndalohet vendosja e posterëve dhe njoftimeve tjera pa leje me shkrim nga ana e menaxherit të palestrës.
18. Ndalohet hudhja dhe dhezja e fishekzjarrëve dhe mjeteve piroteknike

Neni 10

Vendosja e reklamave

1. Reklamimi i sponsorëve bëhet me marrëveshje të posaçme me Komunën, respektivisht me DKRS- në;
2. Reklamimi i sponsorëve bëhet në këto vende: dysHEME, në anësore të fushës, në rrethoja, në mure të objektit, në hapësira të jashtme etj.
3. Palët që vendosin reklamat janë përgjegjës për dëmet eventuale që shkaktohen gjatë vendosjes dhe heqjes së reklamave dhe obligohen që ti marrin përsipër të gjitha shpenzimet për riparimet e nevojshme;
4. Të drejtë për vendosjen e reklamave në objektin sportiv kanë të gjitha firmat/organizatat që arrijnë marrëveshje me klubet sportive dhe Komunën - DKRS.

1. Subjekteve të interesuara u mundësohet vendosja e reklamave të tyre me këto dimensione dhe tarifa mujore

- | | |
|---|-----------|
| 1.1. Ne qendrën e fushë se basketbollit në parket | 150 Euro; |
| 1.2. Në gjysmërrethin e reketit të fushës së basketbollit | 50 Euro; |
| 1.3. Në hapësirën e 7-metërshit të fushës së futsallit.....2x0.60m | 50 Euro; |
| 1.4. Në hapësirën brenda fushës së basketbollit dhe hendbollit2x0.60 m..... | 50 Euro; |
| 1.5. Rreth vijave të fushës së basketbollit dhe hendbollit..... ..3x0.60m..... | 40 Euro; |
| 1.6. Në pjesën anësore(veriore dhe jugore, tek muri) të palestrës.....3x0.60m | 40 Euro; |
| 1.7. Në pjesët tjera të palestrës dimensionit.....2x0.60m | 20 Euro; |

1. Kohëzgjatja e vendosjes së reklamave në vendet e zgjedhura do të jetë deri në 1 (një) vit me të drejtë vazhdimi sipas kontratës së re.
2. Vendi i vendosjes së reklamës caktohet me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes.
3. Shpenzimet e shkrimit, vendosjes dhe zhvendosjes së reklamës i bartë subjekti i cili ka vendosur reklamën.
4. PAGESA për reklamën e ekspozuar bëhet çdo muaj dhe atë në fillim nga data 1-5 të muajit vijues.
5. Në palestrën sportive, klubet mundë të ekspozojnë reklamat lëvizëse të sponsorëve të tyre vetëm gjatë orarit të ndeshjeve të tyre por me kusht që mos të pengohen reklamat ekzistuese në palestër.
6. Në rastet ku paraqiten dy ose më shumë kërkesa për reklamë në të njëjtin vend, përzgjedhja bëhet me licitacion (ofertës dhe kërkesës më të favorshme).
7. Palët që vendosin reklamat janë përgjegjës për dëmet eventuale që shkaktohen gjatë vendosjes dhe heqjes së tyre dhe obligohen që ti marrin përsipër të gjitha shpenzimet për riparimin e nevojshëm.

Neni 11

Dokumentacioni i nevojshëm për shfrytëzim të palestrës

1. Klubet e interesuara për zhvillimin e aktiviteteve të tyre të rregullta sportive duhet të sjellin tek DKRS-së këto dokumente:
 - 1.1. Certifikatën e regjistrimit;
 - 1.2. Certifikatën fiskale;
 - 1.3. Vertetimin e regjistrimit të lëshuar nga DKRS
 - 1.3. Lejen e njoftimit të personit përgjegjës;
 - 1.4. Listën e anëtarëve (lojtarëve) të klubit;
2. Klubet e regjistruara dhe menaxheri i palestrës pas shqyrtimit të kërkesës së klubit lidhin marrëveshje për shfrytëzimin e palestrës.
3. Subjektet tjera që nuk janë klube sportive duhet të paraqesin kërkesën për shfrytëzim.

Neni 12

Pagesat për shfrytëzimin e objekteve në palestër

1. Të gjitha klubet që janë të licencuara në federatat përkatëse dhe të regjistruara në DKRS, apo garojnë në kuadër të Federatave përkatëse e që janë nga Komuna e Kaçanikut mund të shfrytëzojnë palestrën për stërvitje dhe garim në bazë të një orari të rregulluar nga përgjegjësi i palestrës në bashkëveprim me udhëheqësit e këtyre klubeve dhe të vërtetuara nga DKRS, sipas këtyre pagesave, kriterëve:
 - 1.1. Për stërvitje sportive (klubet sportive) pa pagesë (për një orë e tridhjetë minuta)- përparësi niveli garues i klubit;
 - 1.2. Për ndeshje zyrtare si vendas pa pagesë;
 - 1.3. Për grupet formale dhe jo formale komunale.....15 euro pa ndriçim, 20 euro me ndriçim (1 orë);
 - 1.4. Për stërvitje të klubeve dhe shkollave private.....10 euro pa ndriçim, 15 euro me ndriçim (1 orë);
 - 1.5. Për zhvillimin e ndeshjes pa bileta 30 euro (1 orë);
 - 1.6. Për zhvillimin e ndeshjes me bileta 20 % nga mjetet e inkasuara nga shitja e biletave, derdhen në llogarinë bankare të Komunës së Kaçanikut; biletat sigurohen nga DKRS, bileta të cilat do të përmbajë numrin serik, llogon e Komunës së Kaçanikut dhe llogon/vulën e organizatorit të aktivitetit.
 - 1.7. Të gjitha klubet sportive që nuk janë të Komunës së Kaçanikut, të cilat për shkaqe të ndryshme janë të interesuara të shfrytëzojnë Palestrën sportive në Kaçanik duhet të paguajnë 100 euro për një orë;
 - 1.8. Garat komunale, regjionale dhe Republikane të organizuara nga shkollat e komunës së Kaçanikut apo Drejtoria Komunale e Arsimit lirohen nga pagesa e shfrytëzimit të palestrës sportive.
2. Palestra sportive mund të shfrytëzohet edhe për manifestime dhe ngjarje të ndryshme:
 - 2.1. Për ngjarje komerciale (panaire, revy, ekspozita dhe të ngjashme) 200 euro tërë ditor;
 - 2.2. Për ngjarje humanitare pa pagesë;

- 2.3. Për koncerte të ndryshme 30 % nga inkasimi i mjeteve prej biletave ose pagesë fikse sipas marrëveshjes, mjete këto të cilat derdhen në llogarinë bankare të Komunës së Kaçanikut; biletat sigurohen nga DKRS, bileta të cilat do të përmbajë numrin serik, llogon e Komunës së Kaçanikut dhe llogon/vulën e organizatorit të aktivitetit
 - 2.4. Për organizimin e tubimeve elektorale të subjekteve të ndryshme politike 150 € për një orë .
 - 2.5. Nga obligimet financiare lirohen të gjitha aktivitetet që organizohen nga komuna për nder të festave shtetërore, kombëtare, qofshin ato me karakter edukativ, kulturor, sportiv etj.
 - 2.6. Nga obligimet financiare lirohen subjektet : Shoqatat e dalura nga lufta, FSK, njësitë policore , KFOR, shoqatat dhe klubet e personave me aftësi të veçanta të aprovuara nga DKRS .
3. Parkingu i palestrës mund të shfrytëzohet falas nga anëtarët e klubeve frekuentuese për stërvitje dhe ndeshje, Shoqatat e dalura nga lufta, FSK, njësitë policore , KFOR, personat me aftësi të veçanta të aprovuara nga DKRS, ndërsa do të paguajnë të gjithë frekuentuesit tjerë sipas taksave komunale për parkimin e automjeteve .

Neni 13 Masat ndëshkuese

1. Ndaj palëve të cilat nuk e respektojnë rendin shtëpiak dhe nuk i binden menaxhmentit të objektit sportiv do të merren masa ndëshkuese, suspendim i përkohshëm nga e drejta e shfrytëzimit të palestrës me kohëzgjatje të lirë për tu përcaktuar nga përgjegjësi i palestrës dhe nëse përsëritet më shumë se dy herë i njëjti veprim atëherë i merret e drejta për shfrytëzim derisa organizata ose klubi në fjalë është i përbërë nga të njëjtit akterë.
2. Për dëmet eventuale të shkaktuara nga klubet apo subjektet tjera përkatëse përgjegjësia bie te shfrytëzuesi i cili e ka shkaktuar dëmin, andaj kompensimet duhet bërë në afat prej pesë (5) ditëve në xhirollogarinë e komunës së Kaçanikut
3. Dëmet e shkaktuara vlerësohen nga komisioni ad-hoc prej tre anëtarëve të emëruar nga DKRS-ja. i cili duhet të përgatis procesverbal të posaçëm për dëmet e regjistruara
4. Në rast të moskompensimit të dëmeve në afatin e paraparë sipas paragrafit 2 të këtij neni, iniciohet Procedura gjyqësore përmes përmbaruesit privat duke përfshirë edhe kamatën ligjore si dhe ndalesën për mos shfrytëzim deri në zgjidhjen e kontekstit.

Neni 14 Rregullimi dhe ndryshimi i mjedisit

1. Ndryshimet në objektin e palestrës bëhen vetëm me lejen e Komunës - DKRS-së.
2. Projektet për investime kapitale në palestër bëhen duke u bazuar në udhëzimet e akteve ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë veprimtarinë përkatëse.

II. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 15 Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohen Rregulloret dhe Vendimet e miratuara nga Kuvendi i Komunës së Kaçanikut të cilat bien ndesh me dispozitat e kësaj Rregullore.

Neni 16 **Konflikti me ligjin**

Në rast të konfliktit dhe mos përputhje të dispozitave të kësaj Rregullore dhe dispozitave të ligjeve dhe akteve tjera nënligjore, do të aplikohen dispozitat e Ligjit dhe akteve tjera nënligjore që janë të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Neni 17 **Zbatimi i Rregullores**

Për zbatimin e kësaj rregullore do të kujdeset kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport në Komunën e Kaçanikut.

Neni 18 **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit në Kuvendin e Komunës, 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb Faqen e Komunës së Kaçanikut dhe Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Kryetari i Komunës
Besim Ilazi



19.05.2022

Debat publik rreth Draft Rregullorës nr.03./2022 për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të Palestrës Sportive në Komunën e Kacanikut

Pikat e rendit të ditës:

1.Hapja e debatit publik

2.Prezentimi I Draft Rregullorës

3.Diskutim

1.Hapjen e këtij debati publik e bëri Drejtoresha për Kulturë,Rini e Sport Znj.Hafize Sallahu e cila tha se me këtë draft rregullore e cila pritët të miratohet në Kuvend Komunal do të lehtësohet puna dhe menagjimi I palestrës sportive e gjithashtu do të krijohet një rend në shfrytëzimin e hapsirave të palestrës nga të gjithë ata që kërkojnë ta shfrytëzojnë.

2.Prezentimin e draftë rregullorës përmes videoprojektorit e bëri Fatos Vishi Këshilltar për Rini e Sport njëherit kryesues I grupit punues për hartimin e kësaj draft rregulloreje , I cili për fillim falënderoi edhe grupin punues në përbërje Fatos Vishi,Fatmir Qaka,Valdrin Dogani,Kaltrina Luma,Nasurllah Shehu, Ilir Lumi dhe Lulzim Krasniqi për kontributin e dhënë në hartimin e kësaj draft rregulloreje.

3.Pasi u prezentua Draft Rregullorja u hap diskutimi

-Elmihane Krasniqi:ju përgëzoj për punën që keni bërë por që kam një propozim në nenin paragrafi 2.5 të bëhet një plotësim që përpos personave me aftësi të veqanta të hyjnë edhe, organizatat dhe klubet sportive të Personave me Aftësi të Kufizuara ngase për momentin në komunën tonë nuk kemi këso klube por që po mendojmë që në të ardhmen mundemi të kemi, kështu që rregullorja duhet ta ket edhe këtë plotësim.

-Me këtë propozim u pajtuan të gjithë

-Në vazhdim fjalën e mori Besim Halilaj I cili gjithashtu e pargëzoi grupin punues për punën e bërë dhe kërkoi sqarim në Nenin 7 pika 2 rreth kërkesës për shfrytëzim të hapsirës së palestrës .Mendoj se klubet do ta kenë një orarë të aktiviteteve ndërsa nëse vjen një kërkesë në drejtori për ndonjë aktivitet të pa planifikuar apo ndonjë organizim komunal,më intereson të dijë se si do të veproni, gjithashtu duhet të përfshihet shfrytëzimi i palestrës për tubime, fushata elektorale etj....

Fatos Vishi: ashtu siq është e precizuar në rregullore paraprakisht klubet dorzojnë orarin e stërvitjeve dhe aktiviteteve kështuqë nëse vie ndonjë kërkes mund ta dimë sakt se kur kemi hapsirë për atë kërkesë por nëse qëllon kërkesa njëjt me aktivitetin e klubit atëher varësisht nga rëndësia e aktivitetit jepet përparsia por gjithashtu besoj se së bashku me klubet ne do e bëjmë bashkërisht një orarë për shfrytëzimin e palestrës dhe nëse vjen ndonjë kërkesë jashtë planifikimit atëher ne edhe e bisedojmë dhe kordinohemi me klubet duke u mirëkuptuar.

Dardana Tafili-është mirë të ceket në nenin 7 pika 1 që pala e interesuar për shfrytëzim të palestrës duhet të paraqes kërkesë së paku 3 ditë pune para, ngase mundë të qëlloj vikend dhe krijohet keqkuptim.Gjithashtu kërkesat duhet të bëhen në zyrën e pritjes së objektit të komunës ,të protokolohen dhe të përcillen në DKRS.Në kuadër të Drejtorisë së Administratës është edhe personi përgjegjës që I përcjellë kërkesat në destinacionin që pala e ka drejtuar këtë kërkesë.

Kefsere Koxha:kërkesat skanohen te zyrja e pritjes dhe nga aty mundë edhe të përcillen në DKRS.

Besim Halilaj:isha ndalur në nenin 9 si pikë e rëndësishme e që më intereson të dijë se kush e mbanë rendin gjatë zhvillimit të aktivitetit,organizatori apo menaxhmenti I palestrës.

Fatos Vishi:objektin e palestrës e siguron një kompani e sigurimit por që kemi edhe dy punëtorë Teknik që edhe mundë të bashkëpunojmë në raste kur kemi nevojë më shumë edhe pse kjo qështje është e cekur në këtë draft rregullore, ndërsa roganizatori merr përsipër anën organizative të aktivitetit .

Besim Halilaj:mendoj se secili klub apo organizatori i aktivitetit duhet të parashehë se sa afërsisht public do të ketë në atë event dhe nëse mendohet se do të ketë shumë pjesëmarrës atëher të njoftojnë edhe Stacionin e Policisë me qëllim që aktiviteti të ketë mbarëvajtje.

Fatos Vishi: deri më sot nuk kemi pasur ndonjë aktivitet garues por që pa marrë parasysh pjesmarrjes së publikut organizatori duhet të e lajmroj edhe Stacionin e policisë. Për aktivitetin .

Lulzim Krasniqi: kam qenë pjesë e grupit punues të kësaj rregulloreje dhe jemi munduar që ta mbulojmë me të gjitha pikat e nevojshme që duhet për këtë rregullore.Kemi përfshi edhe kriteret e shfrytëzimit të palestrës por edhe kemi lënë hapsirë edhe për aktivitete humanitare.Është marrë parasysh edhe kategoria e personave me aftësi të kufizuara që besoj se i kemi përfshi dhe u kemi bërë trajtim të duhur për aktivitetet e tyre.Sa i përket mbajtjes së rendit mendoj se kjo është e cekur në rregullore dhe qdo parregullsi apo dëmtim të inventarit përgjegjës është vet organizatori që në këtë rast më shumë janë klubet sportive ngase ato do ta kenë më shumë në shfrytëzim këtë object.

Fatos Vishi: është e kuptueshme se në të ardhmën ka me pas kërkesa të ndryshme që neve na obligon që të bëjmë ndonjë ndryshim në rregullore por që për momentin jemi munduar të përfshijmë të gjitha pikat e nevojshme.

Lavdim Mjaku:në nenin 12 pika 1.7. mendoj se pagesa prej 100 euro për klubet sportive që nuk janë të komunës së Kacanikut ,të cilat për shkaqe të ndryshme janë të interesuara të shfrytëzojnë Palestrën Sportive në Kacanik, është e lartë ngase po bazohemi në atë se klubi i basketbollit i komunës tonë ndeshjet i ka zhvilluar në Ferizaj dhe asnjëherë nuk na kanë obliguar për të paguar sallën.

Hafize Sallahu: mendoj se kjo shumë duhet të figurojë në rregullore dhe mvarësisht prej rrethanave ne edhe mundemi të gjejmë ndonjëherë mirëkuptim.

Bashkim Hysa: kam lexuar rregullorën dhe ju përgëzoj për punën që e keni bërë.Nuk kam parë se është bërë ndonjë lëshim por që nuk don të thot se kjo rregullore do të mbetet kështu gjithmonë.

Besim Halilaj:në pjesën ku bëhet fjalë rreth hyrjes në palestër për të përcjellur ndonjë aktivitet mendoj se klubet duhet të kenë triksa me një llogo të komunës apo ndonjë llogo tjetër me qëllim që të mos keqpërdoret , dhe organizimin e hyrjes së publikut në sallë duhet ta merr vet organizatori i atij aktiviteti .E kam fjalën për hyrje pa pagesë për vullnetarët e rinjë,ndonjë nxënësi me suksese të veqanta apo ndonjë aktivisti që komuna mendon se duhet të ju bëhet një e mirë , pasi që egziston edhe ligji për vullnetarizëm që ju mundëson benifite nga institucioni, gjithashtu duhet të precizohet në rregullore edhe pjesëmarrja si shikues e fëmijëve që përpos në aktivitetet edhe si shikues të jenë present vetëm në mbikqyrje të prindit apo trajnerit dhe

Rekomandim: Grupi punues shqyrtoi kërkesat e dalura nga ky debat public dhe e pa të arsyeshme që të njejtat ti plotësojë edhe në draft rregullorën e cila do të paraqitet para asambkeistëve të kuvendit në bledhjen e radhës për miratim.

Procesmbajtës: Fatmir Qaka



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPSTINA KAÇANIK



1	Data	17.05.2022	Vendi	KAÇANIK
Hj. org.	Numri	Shtojcë		
01	104/02-13207	-/-		



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA KAÇANIK

Për: Kuvendin e Komunës Kaçanik
Propozues: Kryetari i komunës, Besim Ilazi
Lënda: Programi komunal trevjeçar i banimit 2022-2025



Në bazë të nenit 12 pika "d" si dhe nenit 17.1, pika "k" të Ligjit mbi Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-40, nenit 6 pika 1, të Statutit të Komunës së Kaçanikut, në funksion të zbatimit të nenit 20, të Ligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit nr. 03/L-164; Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës së Kaçanikut, që në mbledhjen e vet që do të mbahet më datë _____, të miraton:

PROGRAMIN KOMUNAL TREVJEÇAR TË BANIMIT 2022-2025



KOMUNA E KAÇANIKUT

PROGRAMI KOMUNAL TREVJEÇAR I

BANIMIT 2022 - 2025



TABELA E PËRMBAJTJES:

1. Hyrje	
2. Qëllimi	
3. Korniza ligjore	
4. Dokumentet tjera relevante	
5. Procesi i hartimit të programit dhe hapat e ndërmarra	
6. Komisioni për hartimin e programit komunal tre vjeçar të banimit	
7. Profili i komunës së Kaçanikut	
8. Gjendja Faktike	
8.1. Pozita gjeografike	
9. Popullësia	
10. Shfrytëzimi i tokës	
11. Mbulueshmëria me plane	
12. Fondi banesor	
13. Kërkesat faktike për përkrahje	
14. Analiza e fakteve	
15. Analiza ekonomike dhe zhvillimi ekonomik në Komunën e Kaçanikut	
15.1. Toka bujqësore	
15.2. Analiza sociale	
16. Karakteristikat demografike	
16.1. Popullësia	
16.2. Vendbanimet	
16.3. Banimi- Fondi banesor	
16.4. Migrimi	
16.5. Papunësia	
17. Ambienti biznesor në Komunën e Kaçanikut	
18. Kategoritë e synuara	
19. Klasifikimi i nevojave sipas urgjencës së trajtimit të tyre	
20. Veprimet kryesore që do të ndërmerren	
21. Justifikimi i veprimeve dhe spjegimi i rezultateve të pritura	
22. Kohëzgjatja e realizimit të programeve	
23. Korniza e shpenzimeve afatshkurta, afatmesme dhe afatgjate	
24. Korniza buxhetore e Komunës Kaçanikut 2018-2020	
25. Mundësitë e kapaciteteve njerëzore dhe materiale	
26. Mënyra e financimit të programeve komunale tre vjeçare të banimit	
27. Përputhja e programeve me planet zhvillimore të komunës	
28. Instrumentet e mbikqyrjes	
29. Instrumentet e garantimit të realizueshmërisë së programeve	
30. Masat e marra për respektimin e kuadrit ligjor	
31. Përfshirja e publikut në procesin e sigurimit të transparencës	
32. Çështjet tjera	
33. Analiza SWOT	
34. Përfundimi	

1 HYRJE

Banimit është çështje vendimtare për stabilitet social, shëndet dhe zhvillim kualitativ të mirëqenies njerëzore. Banimit si shfrytëzues më i madh i hapësirës ndikon në rrjedhën e zhvillimit të gjithmbarshëm të shoqërisë, njëherit është komponent e rëndësishme e zhvillimit social-ekonomik gjegjësisht standardit jetësor.

Banimit është e drejtë sociale e qytetarëve në shumicën e vendeve të zhvilluara. E drejta në banim gjithnjë e më shumë është prezentë në kuadër të politikave globale dhe në luftë për të drejtat njerëzore, e sanksionuar me konventa ndërkombëtare.

Banimit luan rol kyç në krijimin e vendeve ku njerëzit dëshirojnë të jetojnë - vendet ku dëshirojnë të investojnë për biznes dhe kështu të rrisin mundësitë zhvillimore ekonomike.

Ky dokument do të shërbejë si instrument për të vendosur bazën fillestare për bashkëpunim, ndërlidhje në mes të ekonomisë dhe administratës publike si dhe në disa segmente me pjesëmarrje aktive të qytetarëve.

Ky dokument nuk do të japë zgjidhje të menjëhershme për çështjet kyçe të identifikuar (si mungesa e banimit adekuat, përkeqësimi i banimit ekzistues, urbanizimi i pakontrolluar dhe ndërtimi ilegal) por me punë aktive të të gjithëve do të bëhen ndryshime dhe do të krijohet baza për zgjidhje të qëndrueshme.

2 Qëllimi

Qëllimi i hartimit të Programit komunal tre vjeçar të banimit në komunën e Kaçanikut është adresimi i çështjeve të banimit në territorin e Komunës së Kaçanikut bazuar në politikat qendrore të banimit, nevojat e komunës së Kaçanikut dhe vullnetin politik për realizimin e këtij projekti, duke:

- Identifikuar pasqyrën reale të problemeve në komunën e Kaçanikut, që kanë të bëjnë me çështjen e banimit;
- Zhvilluar politika adekuate përfshirë specifikat lokale, veçoritë gjeografike, demografike dhe institucionale për zbatimin e tyre me qëllim që të mundësohet zgjidhja e nevojave për banim për grupe të caktuara të cilat nuk kanë forcë ekonomike për të siguruar banim me çmime aktuale të tregut;
- Gjetjen e mënyrave të financimit për realizimin e zbatimit të Programit komunal tre vjeçar të banimit;
- Krijuar kushte për banim të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm në harmoni me standardet dhe normat e tanishme të banimit.

Në këtë aspekt programi i nënshtrohet zbatimit të metodës së planifikimit strategjik në fushën e banimit duke dhënë përgjigje:

- *Ku jemi?*, Që i referohet analizës së gjendjes ekzistuese;
- *Ku do të shkojmë?* Synimet, objektivat;
- *Si të arrijmë atje?* Idetë, veprimet, projektet etj.
- *Si të bindemi se kemi mbërri?* Monitorimi dhe vlerësimi.

Dokumenti është përgatitur në përputhje me Udhëzuesin për hartimin e programeve komunale tre vjeçare të banimit bazuar në Ligjin Nr. 03/L-164, “Për financimin e programeve të veçanta të banimit” dhe është hartuar nga grupi punues komunal në konsultim me zyrtarët e MMPH’së. Programi tenton të përshkruaj rrjedhën logjike të banimit që nga themelimi i qytetit, gjenden ekzistuese dhe projeksionet e zhvillimit të banimit në vitet në vijim.

3 Korniza ligjore

- Ligji Nr.03/L-164, Për financimin e programeve të veçanta të banimit,
- Udhëzimi Administrativ- Për Përmbytjen e kontratës për banesën me qira joprofitabile,
- Udhëzimi Administrativ- Për përmbytjen e bonusit të banimit,
- Udhëzimi Administrativ- Për procedurat e përfitimit nga programet e veçanta të banimit,
- Udhëzimi Administrativ- Për normat e banimit për programet e veçanta të banimit,
- Udhëzimi Administrativ- Për procedurat e shpalljes të programeve të veçanta të banimit,
- Udhëzimi Administrativ- Për përcaktimin e radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit,
- Ligji Nr. 03/L – 091, Për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesës në bashkëpronësi,
 - Ligji Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale,
 - Ligji Nr. 04/L-061 , Për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore,
 - Ligji Nr.05/L-031, Për procedurën e përgjithshme administrative.


4. Dokumentet tjera relevante

- Statuti i Komunës Kaçanik,
- Plani Zhvillimor Komunal dhe Plani Zhvillimor Urban (2010-2020),

Në hartimin e këtij Drafti ndihmë në ofrimin e të dhënave, kanë dhënë edhe;

1. Zyra e punësimit në Kaçanik;
2. Zyra e tatimit në pronë në Komunën e Kaçanikut;
3. Qendra për punë sociale në Kaçanik;
4. Zyra komunale për komunitete dhe kthim.

5. Procesi i hartimit të programit dhe hapat e ndërmarra



Diagrami i hierarkisë në proces të hartimit të Planit komunal tre vjeçar të banimit.

6. Komisioni për hartimin e programit komunal tre vjeçar të banimit

	Emri dhe Mbiemri	Drejtoria	Përgjegjësia në Komision
	Fadil Guri	Zyra për kthim dhe komunitete	Kryesues
	Eljesa Begunca	Drejtoria e Shërbimeve Publike	Anëtar
	Visar Mulaku	Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit	Anëtar
	Hajredin Shehu	Drejtoria e Shërbimeve Publike	Anëtar
	Avdi Vërbani	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	Anëtar

- Vendimi 01 Nr.104-02-8156-22 i Kryetarit të Komunës së Kaçanik i datës 22.03.2022 për hartimin e Programit komunal tre vjeçar të banimit të komunës së Kaçanikut për periudhën 2022-2025;

- Sigurimin e të dhënave nga fushat përkatëse të komunës (Enti i Statistikave, Drejtoria e Arsimit, Qendra për Punë Sociale, Qendra për Punësim);
- Identifikimi i grupeve të synuara;
- Kategorizimi i grupeve dhe klasifikimi i kërkesave për përcaktimin e radhës së përparësisë (UA Nr.21/2010) për gjendjen faktike të çështjes së banimit;
- Struktura e Buxhetit Komunal të Kaçanikut;
- Përgatitja e dokumentit;
- Bërja publike e PTB (Programit Trevjeçar të Banimit) – Informimi;
- Procedurat e miratimit të dokumentit;
- Aprovimi nga Kuvendi i Komunës;
- Dërgimi i Planit komunal trevjeçar të banimit në MMPH.

7. Profili i Komunës së Kaçanikut

Kaçaniku me rrethinë është vendbanim i banuar nga kohët e lashta. Këtë e dokumentojnë shumë burime arkeologjike. Gjurmët më të zakonshme janë themelet e kalave, varrezave dhe materiale, gjetje të ndryshme arkeologjike nëpër territorin e komunës si dhe emërtimet e ndryshme të cilat gjenden në shumë lokalitete të komunës tonë.

Kjo hapësirë në kohën e ilirëve ishte pjesë e Dardanisë. Në vitin 395 kjo trevë bie nën sundimin e perandorisë Bizantine që zgjati deri kah mesi shek. IX. Emri i Kaçanikut është i vjetër dhe në defterët osman haset si “Kaçanikllër”, domethënia tij në literaturën shqipe sqarohet si vend me kaçë.

Sipas defterëve osman në periudhën 1873-1912, Kaçaniku emërtohej me emrin „Orhanie”.

Kah fundi i shek XII sllavët depërtuan në këto pjesë, ndërsa Stefan Dushani pushtoi Maqedoninë, Shqipërinë dhe Thesalinë, ndërsa rezidencë e bëri Prizrenin. Nga kjo kohë fillon ndërrimi i toponimeve dhe përvetësimi i kishave katolike shqiptare. Në shek. e XIV turqit osmanë ia mësynë Ballkanit, mendohet se Kaçaniku u pushtua diku kah viti 1392 dhe sipas defterëve turq ishte si nahi e Vilajetit të Shkupit. Kaçaniku si qendër administrative – qytezë, daton që nga fundi i shekullit XVI, i cili deri në vitin 1891 ishte nahije e Sanxhakut të Shkupit, në Vilajetin e Kosovës. Themelues i parë i kësaj qyteze është Koxha Sinan Pasha i cili ndërtoi xhaminë e cila edhe sot ekziston, një kuzhinë publike (imaret), një shkollë në afërsi të xhamisë, dy hane, një hamam, kalanë dhe disa mullinj në lumin Lepenc. Kalaja që ekziston edhe tani është ndërtuar gjatë shekujve XIV-XVI. Gjatë sundimit turk, në vitin 1689 njihet lufta austro-turke. Austriakët pushtuan Nishin, pastaj Prishtinën dhe trevën tonë. Në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare që kishte filluar në fillim të shek XIX kishte marrë pjesë edhe popullata e kësaj ane. Ndërsa nga shpërngulja e dhunshme e vitit 1878 nga Sanxhaku i Nishit, një pjesë e vogël e muhaxhirëve ishte e vendosur edhe në këtë trevë.

Në vitin 1879 ndërtohet hekurudha Prishtinë–Shkup, që në këtë qytet solli zhvillimin e tregtisë. Aspiratat për pavarësi u përcollën me kryengritje, ndërsa Kuvendi i mbajtur në Ferizaj me 20 korrik 1908 u përkrah pa rezervë nga popullata e kësaj ane.

Është e njohur beteja e Kaçanikut me 1910 e udhëhequr nga patrioti Idriz Seferi. Pasi e pushtuan grykën ata morën pjesë edhe në çlirimin e Shkupit.

Pas dobësimit dhe përfundimisht tërheqjes së pushtetit osman më 1912, këto treva i okupoj Serbia dhe Mali i Zi. Okupimi i ri u përcjell me shume vrasje djegie të vendbanimeve dhe shpërngulje të popullatës. Që nga kjo kohë shumë shqiptarë nga kjo anë morën rrugën e emigrimit për në Turqi për mos tu kthyer më kurrë në vatrën e tyre.

Gjatë Luftës së I-rë botërore kjo trevë ishte nën okupimin bullgar të cilët poashtu djegën fshatra, vranë popullatë vendase e deri te internimet.

Në vitin 1918 u bë ripushtimi serb i cili më vonë filloi me konfiskimin e tokave shqiptare duke iu

dhënë kolonëve serb të cilët i kishte sjellë për ndërrimin e strukturës etnike.

Rezistenca shqiptare ishte e manifestuar me lëvizjen kaçake (ka ekzistuar edhe me herët) e cila i kishte përfshi edhe këtë trevë.

Gjatë luftës së II-të botërore territori i Kosovës u nda në tri pjesë, ndërsa hapësira e Kaçanikut u vu nën administrimin bullgar.

Në vitin 1941 është ndërtuar hekurudha me binarë të ngushtë për transportin e xehes së kromit Kaçanik-Vorboshticë.

Me mbarimin luftës njësitë partizane kishin marrë fushata të ashpra të dhunës. Ndërsa në gjoja mobilizimin e popullatës ata i drejtuan drejt masakrës së Tivarit, ku kishte edhe qytetarë të Kaçanikut me rrethinë. Në kanalin e Trogirit ranë 29 martirë nga kjo anë.

Gjatë periudhës 1943-1963, për shkak të aktiviteteve që nuk ishin në frymën e PKJ-së, janë gjykuar 26 e disa prej tyre edhe me pushkatim (rreth 33 vetë).

Nuk ka munguar dhuna shtetërore as në periudhën e Rankoviqit dhe në demonstratat e vitit 1981 e 1989.

Pas suprimimit të autonomisë së Kosovës me 28 mars 1989, shqiptarët u organizuan dhe me 2 korrik 1990 shpallën Deklaratën kushtetuese për pavarësinë e Kosovës.

Me 7 shtator 1990, Kuvendi i Kosovës në Kaçanik miratoi Kushtetutën e Kosovës e njohur si „Kushtetuta e Kaçanikut”.

Në luftën kundër okupatorit në këto anë, ishin formuar celulatat e para të UÇK-së të cilat më vonë u zgjeruan. Edhe në këtë komunë u zhvilluan shumë beteja të UÇK-së.

Gjatë kësaj periudhe dhe gjatë periudhës së bombardimeve të NATO-s popullata ka pësuar mjaft humbje si njerëzore ashtu edhe materiale. Kjo anë për shkak të pozitës strategjike ka pasur edhe koncentrim më të madh të forcave serbe.

Popullata e kësaj komune është shpërngul në shumë vendbanime të Maqedonisë dhe në Turqi ndërsa në periudhën e 1990-1999 edhe nëpër Evropë.

Nëpër Kaçanik kalojnë dy lumenjë, Lepenci dhe lumi Nerodime, që me bashkimin e tyre në të dalë nga qyteti në pjesën jugore, kalojnë tok grykën piktoreske të Kaçanikut me tërësi të veçanta mezo-reliefë të Kosovës, nga buzët e të cilëve ngrihen malet e rrëpishme që u përkasin masiveve të Sharrit dhe Rodopeve.

Kaçaniku kryesisht është vend industrial, mirëpo ekzistojnë kushte të volitshme për zhvillimin e blegtorisë, bletarisë, pemëtarisë, zejtarisë e në veçanti kushte të mira për zhvillimin e turizmit dimëror-sportiv, veror, malor dhe transit.

Nëpër Kaçanik kalojnë magjistratja Prishtinë – Shkup dhe hekurudha Fushë Kosovë – Selanik, e ndërtuar në vitin 1879, Autostrada e kombit “Arbër Xhaferi” (e cila është në ndërtim e sipër), ndërsa fakti tjetër se komuna e ka edhe vendkalimin kufitar në Gllaboçicë, e bënë Kaçanikun vend të rëndësishëm dhe strategjik në rrafshin ekonomik, turistik, të bashkëpunimit ndërkufitar etj.

8 Gjendja faktike

8.1 Pozita gjeografike:

Komuna e Kaçanikut shtrihet në pjesën jugore të Kosovës.

Kufizohet me komunat Ferizaj në veri, Viti në veri-lindje, Shtërpçen në veri-perëndim, Hanin e Elezit në jug, Republikën e Maqedonisë në jug-lindje dhe jug-perëndim.

Gjatësia e vijës totale kufitare është 101.41 km.

Komuna e Kaçanikut ka sipërfaqe prej 211.40 km².

Komuna e Kaçanikut shtrihet rreth koordinatave gjeografike 42°14'48" dhe 21°15'19".

Nën administrimin e Komunës Kaçanikut janë 30 fshatra me një qendër administrative d.m.th janë 31

vendbanime.

Krejt këto janë të ndara në 29 Zona kadastrale.

Komuna e Kaçanikut sipas regjistrimit të fundit në vitin 2011 ka 33409 banorë.

Komuna Kaçanik				
Nr. i popullsisë			33409 banorë	
Zonat rurale			10393 banorë	
Zonat urbane			23016 banorë	
Nr. i fshatrave/nr i lagjeve			30 fshatra dhe 1 zonë urbane	
Banimi individual	Nr. objekteve para 1999		5250 objekte	
	Nr. objekteve pas 1999		9725 objekte	
	Etazhiteti mesatar		P+1, para 1999 P+2, pas 1999	
Banimi kolektiv	Para 1999	Nr. objekteve	13 objekte	
		Nj. banimi	168	
	Pas 1999	Nr. objekteve	22 objekte	
			671 nr. i banesave	
	Etazhiteti mesatar		P +5	
Statusi pronësor (banim kolektiv) para 1999		Privat (nj. banimi)	13	
		Shoqëror (nj. banimi)	168 nj. banimi	
			-//-	
Numri i kërkesave për zgjidhjen e çështjes së banimit			120	
Lokacionet (sipërfaqja e tokës) për programet e veçanta të banimit			Kaçanik i Vjetër	
Nr. i objekteve/nj. banimi e ndërtuara nga Komuna, Qeveria dhe Donatorët			1	
Nr. i objekteve/nj. banimi me qira nga dhe vlera mes. e qirasë			/	
Nr. i objekteve/nj. banimi të disponueshëm për qira të ulëta të tregut			/	
Nr. i objekteve/nj. banimi në pronësi të Komunës që mund të adaptohen			/	
Qendrat e përkohshme kolektive (QPK)	Numri i QPK			
	Vendndodhja /emërtimi		1. Objekti i ish senatoriumit	
	Nr. i familjeve		1. 4 familje	
	Nr. i banorëve		1. 15 banorë	

9. Popullsia

Dendësia	158.03 banorë/km ²
Mosha (kryesisht % e moshës së re)	0-9 vite 6181, 10-19 vite 6795, 20-29 v. 5822, 30-39 v. 5121, 40-49 v. 4002, 50-59 v. 2651, 60-69 v. 1723, 70-79 v. 845, 80 + v. 269,
Familja mesatare	Zona urbane 5.7 Zona rurale 6.2
Nataliteti	Nuk kemi të dhëna zyrtare
Migrimi	17.80 % sipas PZHK

10. Shfrytëzimi i tokës

Sipërfaqja e tokës ndërtimore	182.20 ha (sipas PZHU)
Sipërfaqja e planifikuar - tokë bujqësore	7462.70 ha
Sipërfaqja e tokës në komercion	-/-
Sipërfaqja totale e banimit (e ndërtuar)	843.30 ha
Sipërfaqja e banimit të planifikuar	843.30 ha
Individual	841.65 ha
Kolektiv	1.65a

11. Mbulueshmëria me plane

Sipërfaqja e përgjithshme e komunës e përfshirë në PZHK	211.40 km ²
PZHU	182.20 ha
Mbulueshmëria me Plane Rregulluese	80.68 ha ,
Nr. i vendbanimeve joformale në komunë	6 lokacione sipas PZHK

12. Fondi banesor

Nr. i objekteve të banimit	5250 objekte (para 1999) 7844 objekte (pas 1999)
Nr. i banesave në pronësi komunale (në kuadër të objekteve kolektive)	Nuk ka
Me Partneritetin Publik Privat	Nuk ka
Qendra për banim social	1 objekt në ndërtim me 24 banesa,
QPK (Qendra të përkohshme kolektive)	1. Objekti i ish Senatoriumit

13. Kërkesat faktike për përkrahje

Komisioni ka konstatuar se në komunë aktualisht janë të deponuara 120 kërkesa nga persona të ndryshëm dhe nga pjesëtarët e shoqatave të dala nga lufta. Mirëpo kjo shifër nuk reflekton në tërësi nevojat për banim të veçantë në komunë.

13. Kërkesat faktike për përkrahje	
Me asistencë sociale	90 kërkesa të tanishme
Kategoritë e dala nga lufta 1	12 kërkesa
Të kthyerit	6 kërkesa
Të riatdhesuarit	5 kërkesa
Të moshuarit	5
Të rinjtë	n/a
Të punësuarit nga buxheti shtetëror	2 kërkesa
Minoritetet	nuk ka
Tregu i banimit	i pa organizuar
Shitja e banesave në treg	350 - 420 € m ²
Të dhëna me qira	n/a
Me qira në kushte të caktuara	Nuk ka
Pa qira	Nuk ka

14. Analiza e fakteve

Në komunën e Kaçanikut investimet në sektorin e banimit kanë filluar menjëherë pas çlirimit gjegjësisht pas konstituimit të organeve komunale.

Investimet përfshinin ndërtimin e infrastrukturës dhe krijimin e kushteve më të mira për jetë.

Këto investime mund ti klasifikojmë në dy faza:

Faza e parë - kishte të bënte me fazë emergjente për përmirësimin e kushteve elementare për banorët e saj të cilëve u ishte shkatërruar ekonomia familjare, dhe

Faza e dytë - përfshin periudhën e investimeve kapitale ose krijimin e kushteve më të mira për jetë me një infrastrukturë më të zhvilluar dhe përpjekjen për zhvillimin e ekonomisë për qytetarët e komunës sonë.

Falë ndihmës së organizatave bëmirese ndërkombëtare, CARE, MPDL, CARITAS, CDI, CDF, CAP ANAMUR-i gjerman, etj. pas luftës është bërë rindërtimi i një numri të madh të objekteve të banimit individual të shkatërruara e të dëmtuara nga lufta.

Pas luftës, ishte procesi i kthimit të refugjatëve në njërin anë dhe migrimi i një pjese të popullatës nga

viset malore të komunës në zonën urbane dhe disa pjesë rurale të komunës. Komuna e Kaçanikut brenda mundësive të saja buxhetore ka ndihmuar në disa raste me mjete financiare disa persona me kushte të vështira materiale për ndërtim të objekteve të banimit individual. Në disa raste disa persona janë ndihmuar edhe me material ndërtimor. Të tilla raste nuk janë të shumta për shkak të buxhetit të vogël të komunës. Në vitin 2017 në Kaçanik të Vjetër është filluar me ndërtimin e një objekti kolektiv të banimit social për persona që nuk kanë mundësi për zgjidhje vetanake të çështjes së banimit.

15 Analiza ekonomike dhe zhvillimi ekonomik në Kaçanik

15.1 Toka bujqësore

Bazuar në konfiguracionin që ka komuna jonë, kushteve klimatike që mbizotërojnë dhe strukturën e popullsisë, shihet se ka një potencial për zhvillim të bujqësisë si një degë e rëndësishme për zhvillim ekonomik. Pjesën më të madhe të sipërfaqes e mbulojnë pyjet me 58,92%, ndërsa 41,08% e sipërfaqes është ara, kopshte, livadhe dhe djerrina, nga e cila 35,7% është tokë e punueshme.

Struktura e përgjithshme e tokës në Komunën e Kaçanikut.

Struktura e tokës	Sipërfaqja në ha
Pyje	12449.09.84
Ara	3086.85.88
Kopshte	01.58.73
Pemishte	115.90.30
Vreshta	02.78.33
Livadhe	2008.25.29
Kullosë	2367.53.41
Tokë jo pjellore	1094.63.07
Totali	211.266.485

Nga tabela kuptohet se Kaçaniku ka fond të konsiderueshëm të tokës bujqësore dhe të pyjeve të cilat paraqesin potencial të rëndësishëm ekonomik të kësaj komune.

Degët e bujqësisë të cilat zhvillohen në komunën e Kaçanikut janë pemtaria, bletaria, blegtoria lavërtaria (mbjellja e drithërave, perimeve). Shënimet e lartëcekura janë nga aero inqizimi i vitit 1958.

15.2 Analiza sociale

Në komunën e Kaçanikut raste sociale të përfshira në skemën e asistencës sociale janë afërsisht 800 familje, me afërsisht 3200 banorë. Një numër i konsiderueshëm i tyre jetojnë në kushte jo të mira të banimit dhe kanë nevojë për përmirësimin e tyre, ndërsa një pjesë tjetër që kanë paraqitë edhe kërkesë nuk plotësojnë as kushtet minimale për banim. Me gjendje edhe më të rëndë socio ekonomike, gjenden familjet të cilat për shkak të mos përmbushjes së ndonjë kriteri të ligjit për skemën sociale, janë përjashtuar nga skema e asistencës sociale edhe pse gjendja e tyre ekonomike është shumë e rëndë.

Disa prej familjeve përfutuese të skemës sociale, kanë edhe anëtarë të familjes me aftësi të kufizuara për çka edhe ballafaqohen me mungesë të një mirëqenie materiale duke pas edhe probleme shëndetësore.

Jo më pak është edhe numri i kategorive në vijim: Fëmijët pa përkujdesje prindërore, të strehuar te të

afërmit, nënat kryefamiljare, të moshuarit pa përkujdesje, familjet strehuese të fëmijëve etj. Gjendjen e rëndë sociale në Komunën e Kaçanikut e ka rënduar privatizimi i fabrikës së gëlqeres, “Neë Lepenci”, fabrikës së betoneve poroze “Sillkapor”, privatizimi i NT “SHARR –Tregtia”, e disa organizata tjera punuese, ku krejt nga këto janë mbet pa punë mbi 700 punëtorë. Nevojat për banim janë më tepër se sa numri rasteve sociale, ngase edhe shumë familje të cilët kanë ndonjë anëtar të punësuar, janë në pamundësi që të ndërtojnë shtëpi apo të blejnë banesë dhe kanë nevojë për një mundësi më të përballueshme të sigurimit të banesës me një qera të përballueshme.

Të punësuarit në sektorin publik:

Administrata komunale	Nëpunës civil	Stafi politik	Shërbimet teknike	Pylltarët
Numri i të punësuarve	91	17	13	8

Arsimi	Stafi mësimor dhe ai teknik
Numri i të punësuarve	467+63

Shëndetësia	Stafi shëndetësor dhe ai teknik
Numri i të punësuarve	99

Stacioni i autobusëve -	7 të punësuar;
KRUK “Bifurkacioni”-	30 të punësuar;
KRM “Pastërtia ”-	37 të punësuar;
Njësia e zjarrfikësve -	18 të punësuar;
Shërbimi policor i Kosovës -	67 pjesëtar;
Gjykata Themelore Ferizaj - Njësia në Kaçanik –	27 zyrtarë.

Në sektorin privat kryesisht të punësuarit janë në fabrikën “KIVO”, “X-FORT”, në marketet tregëtare dhe lokalet hoteliere, punëtoritë e ndryshme zejtare pa përjashtuar edhe sektorin e ndërtimit. Të dhëna të sakta mbi numrin e të punësuarve në këtë sektor nuk kemi.

16 Karakteristika demografike

16.1 Popullsia

Kaçaniku ka 33409 banorë.
Zonat rurale kanë 23016 banorë ndërsa zona urbane 10393 banorë.
Kaçaniku ka sipërfaqe prej 211.40 km².
Ka 30 fshatra dhe 1 qendër urbane.
Dendësinë e banimit 158.03 banorë/km².

16.2. Vendbanimet

Komuna ka 30 fshatra me një shpërndarje jo të balancuar të vendbanimeve.
Komuna e Kaçanikut ka mikropozitë relativisht të mirë gjeografike ngase ka lidhje të mira dhe funksionale me qendrat përreth. Ndodhet afër kryeqendrës-Prishtinës, në largësi 58 km, nga Ferizaji 21 km, nga Gjilani 45 km dhe me Shkupin e ndan distanca 30 km.

Pozita e qendrës komunale ndaj vendbanimeve të komunës është pjesërisht e mirë ngase ndodhet pothuajse në qendër të sipërfaqes dhe nuk i ndajnë distanca të largëta.

Relievi i shprehur malor ndikon në shtrirjen e rrugëve dhe vështirëson lidhjen e vendbanimeve me qendrën komunale.

Fshatrat Kërbliq, Drenogllavë, Nikoc, nuk kanë lidhje të mira me qendrën komunale.

Për shkak të lidhjeve komunikative disa fshatra shërbimet e tyre i përmbushin në qendrat përreth që janë më afër, ndërsa me qendrën komunale komunikojnë vetëm për çështje administrative.

Komuna e Kaçanikut ka makropozitë të volitshme gjeografike. Nëpër këtë territor kalonin rrugë të vjetra. Këtu edhe tani kalon rruga nacionale Prishtinë-Shkup që shtrihet edhe në vet qytetin e Kaçanikut. Përmes këtij korridori lidhet kah juglindja me Maqedoninë dhe më tutje me rrugët ndërkombëtare si nga jugu, veriu, e njashtu edhe me lindjen. Kjo vijë komunikative ka rëndësi në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Përmes saj hynë pjesa më e madhe e mallrave në Kosovë. Kah veriu përmes rrugës nacionale lidhet me korridoret tjera që shkojnë në drejtim të Adriatikut dhe veriperëndimit.

Lidhje tjetër që funksionon është ajo Gllloboçicë-Tetovë që e lidhë komunën tonë e me këtë edhe këtë pjesë të Kosovës me Pollogun në Maqedoni dhe me Maqedoninë perëndimore. Njëkohësisht këtu është edhe kalimi kufitar me këtë republikë që kalojnë mallra dhe njerëz.

Në vitin 1879 u ndërtua hekurudha që kalon përmes qytetit të Kaçanikut. Këtu kalon vija ndërkombëtare hekurudhore Athinë-Shkup-Fushë Kosovë-Beograd-Zagreb-Lubjanë-Minhen.

Deceniet e fundit komunikacioni hekurudhor ka ngec për shkak të konflikteve dhe është humb kjo vijë e rëndësishme.

Kushtet natyrore përkatësisht lugina e lumit Lepenc ka ndikuar që kjo komunë të ketë lidhje të mira që e avancojnë pozitën e saj gjeografike.

Territori i komunës dhe emërtimet e fshatrave apo vendbanimeve janë të përcaktuar me Ligjin për Kufijtë Administrativë të Komunave.

Komuna e Kaçanikut është e përbërë prej këtyre fshatrave:

Soponicë, Duraj Gabrricë, Elezaj, Nikaj, Nikoc, Gajre, Gjurgjedell, Biçec, Gërlica e Epërme, Kovaçec, Doganaj, Bob, Runjevë, Gllloboçicë, Begracë, Vatë - Dubravë, Rekë, Llanishtë, Kotlinë, Bajnicë, Korbliq, Semajë, Drenogllavë, Strazha, Sllatinë, Stagovë, Kaçanik i Vjetër, Ivajë, Koxhaj dhe qyteti i Kaçanikut.

- **Vendbanimet joformale** janë të integruara në PZHK dhe PZHU.

16.3. Banimi – Fondi banesor

Numri i përgjithshëm i ekonomive familjare në komunën e Kaçanikut, për momentin është rreth 7844, ndërsa numri objekteve kolektive të banimit është 28. Kyçe në kanalizim kanë 94.54% të ekonomive familjare ndërsa në rrjet të ujësjellësit janë të kyçur 95.6% e tyre. Deri tani në një shtëpi kanë jetuar dy deri në tri gjenerata, por trendet e zhvillimit tregojnë që dita ditës shprehet nevoja për njësi të reja banimi për çifte të ndara nga familjet tradicionale si dhe çifte të reja.

Gjendja fizike e shtëpive dhe objekteve të banimit kolektiv është relativisht e mirë, ngase shumë objekte të banimit kolektiv janë ndërtime të reja (të ndërtuara pas vitit 1999), ndërsa ato të vjetrat, kanë qenë të ndërtuara me material të fortë, gjë që gjendja e qëndrueshmërisë dhe sigurisë për banorët është në nivelin e kënaqshëm.

Deri më tani çështjen e banimit në komunë e ka adresuar Drejtoria e Urbanizmit dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, në mungesë të sektorit të veçantë për këtë çështje. Me miratimin e Ligjit për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit Nr. 03/L-164, komuna është e obliguar të themelojë njësinë apo sektorin e banimit.

16.4. Migrimi

Migrimet e popullsisë sot paraqesin një problem shumë dimensional hapësinor, demografik, ekonomik, social dhe politik, ndërsa i nxisin një varg faktorësh të ndërlikuar dhe shpeshherë reciprokisht të lidhur e të kushtëzuar.

Me ndikimin e një varg faktorësh të natyrave të ndryshme si ata socio-ekonomik, politik, kulturor, demografik etj. në Komunën e Kaçanikut janë evidentuar një numër i konsiderueshëm i emigrantëve. Gjatë regjistrimit (2009 për nevoja të punimit të PZHK), janë evidentuar 6795 emigrantë, që përfshijnë 17,8 % të popullsisë së gjithmbarshme. Këta emigrantë janë të shpërndarë në vende të ndryshme të Evropës dhe të botës, ku përfshijnë rreth 27 vende të ndryshme kryesisht në Evropë, por ka edhe në kontinentin e Amerikës, etj.

Migrimet e përhershme apo definitive janë ato migrime, kur njerëzit kanë migruar në një vendbanim apo komunë tjetër për të jetuar përgjithmonë. Të dhënat për këto migrime gjithashtu janë marrë nga regjistrimi i popullsisë, ku del se numri i tyre - që janë shpërngulur nga komuna e Kaçanikut është 97 persona apo 0,25 % e popullsisë së përgjithshme. Ata kryesisht kanë migruar në qytetin e Ferizajit, Prishtinës, Fushë Kosovës Vitisë, etj. Ky numër është variabil pasi kjo dukuri vazhdon dhe në momentin e punimit të këtij drafti.

Migrimi i popullsisë sipas vendeve.

Nr.	Shteti	Nr. i emigr.	%	Nr.	Shteti	Nr. i emigr.	%
1	Gjermani	2955	43.5	15	Finlande	27	0.4
2	Zvicër	1590	23.4	16	Çeki	20	0.3
3	France	387	5.7	17	Holande	20	0.3
4	Amerike	340	5	18	Slloveni	14	0.2
5	Angli	245	3.6	19	Irak	7	0.1
6	Itali	238	3.5	20	Afganistan	7	0.1
7	Austri	217	3.2	21	Turqi	7	0.1
8	Suedi	211	3.1	22	Kroaci	7	0.1
9	Kanada	122	1.8	23	Shqipëri	7	0.1
10	Belgjike	115	1.7	24	Spanje	7	0.1
11	Norvegji	88	1.3	25	Australi	7	0.1
12	Danimarkë	75	1.1	26	Mali I Zi	7	0.1
13	Maqedoni	41	0.6	27	Irlandë	7	0.1
14	Greqi	27	0.4				
Total						6795	100

Lufta e vitit 1998 dhe 1999, ka ndikuar që të ketë lëvizje të theksuar të banorëve prej fshatrave të viseve malore në qytet dhe disa pjesë rurale të komunës. Në migrimin e banorëve ka ndikuar dhe mungesa e mjaftueshme e infrastrukturës nëpër fshatra. Statistika të sakta për numrin e lëvizjes së banorëve nga këto fshatra në momentin e punimit të këtij drafti nuk kemi përveç që dihet se ka fshat

që është boshatis në tërësi prej banorëve, siç është fshati Nikoc, pastaj pjesa e vjetër e fshatit Ivajë pothuajse është boshatisur.

Po ashtu ka tendencë që edhe në disa fshatra që jetojnë pak banorë të ketë lëvizje dhe boshatisje të tyre si psh Drenogllava, Gjurgjedelli, Llanishta, Kërbliqi, etj.

Shumë banorë të cilët kanë migruar në qytet apo në lokalitete tjera të komunës tonë si dhe në komunën e Ferizajt dhe Vitisë e komuna të tjera, e kanë patur të zgjidhur çështjen e banimit por, mungesa e infrastrukturës rrugore, infrastrukturës së mirë shkollore në ato kohë si dhe tendencat e tyre për jetë më të mirë ka nxitur migrimin e tyre.

16.5. Papunësia

Papunësia në Komunën e Kaçanikut, si edhe në shumë komuna të tjera të Kosovës është e lartë. Tabela e punëkërkesve sipas përgatitjes profesionale dhe gjinisë të evidentuar në Zyrën e Punësimit në Kaçanik, të lajmëruar deri në fund të vitit 2021, (supozohet që ka edhe shumë të tjerë, që nuk janë të regjistruar në këtë zyrë), është:

Kualifikimi	Nr. i përgjithshëm	Femra	Meshkuj
Të pakualifikuar	4168	2797	1371
Gjysëm të kualifikuar	256	121	135
Të kualifikuar	955	51	904
Shkollë e mesme	2113	756	1357
Shkollë e lartë	24	3	21
Fakulteti	91	44	47
Gjithsej:	7607	3772	3835

Si rezultat i papunësisë dhe gjendjes së rëndë ekonomike në Komunën e Kaçanikut, numri i familjeve që jetojnë në asistencë sociale, është si në vijim:

Numri i familjeve me asistencë sociale	
Periudha	Numri i familjeve
2015	855.5
2016	800.16
2017	814.25
2018 (muaji prill)	830

17. Ambienti biznesor në Komunën e Kaçanikut

Duke pasur parasysh pozitën e mirë gjeografike të Kaçanikut,

potenciale të tokës bujqësore dhe traditës industriale në komunën e Kaçanikut, zhvillimi ekonomik i Kaçanikut në prespektivë aftshkurtër duhet të orientohet në këto segmente:

- Turizmi malor (malet e Sharrit),
- Agrobiznesi,
- Përpunimit të drurit,
- Industria e prodhimeve të materilait ndërtimor,
- Përpunimit të tekstilit,
- Përpunimi i produkteve ushqimore,

Përqëndrimi në këto degë, ndonëse nuk janë novatore dhe nuk kërkojnë fuqi të madhe intelektuale, ato përfshijnë një numër të madh të fuqisë punëtore duke ndikuar kështu dukshëm në zbutjen e papunësisë, si dhe zhvillimi i këtyre degëve mundëson zëvendësimin e produkteve të importuara me prodhime vendore dhe bëjnë të mundshme eksportimin e këtyre prodhimeve.

Me qëllim të zhvillimit të këtyre sektorëve ekonomik, duhet të ndërmerren një sërë masash, me qëllim të nxitjes së kapitalit privat që të investojë në këto degë. Autoritetet qendrore duhet të krijojnë politika zhvillimore të favorshme për investitorët privat, duke krijuar lehtësira doganore dhe fiskale për repromaterial dhe pajisje. Autoritetet komunale duhet të hartojnë plane zhvillimore rajonale ku do të përcaktohen qartë zonat e zhvillimit komercial.

Sa i përket agrobiznesit, ai duhet të zhvillohet në dy rrafshë, në zonat rurale të rrafshita, kryesisht prodhimet tradicionale: kulturat lavërtare; patatja, gruri, misri, luledielli, fasulja, qepa, lakra etj. Është treguar mjaft i sukseshëm edhe ndërtimi i serrave, ku me sipërfaqe të vogla arrihen rezultate të mira duke u prodhuar edhe për treg dhe punësojnë një numër të të papunëve. Sipas një parallogarie, investimi në një serrë në vlerë prej 6.000 € mund të punësohen 3-5 persona.

Në zonat rurale më bregore, të investohet në plantacione, sidomos në molla, dardha dhe kumbulla. Ndërsa në zonat më malore të zhvillohet blegtoria, ka potencial për ferma të vogla të deleve, dhive, lopëve qumështore dhe për majmëri etj.

Në këto zona mund të zhvillohet edhe turizmi dhe rekreacioni, siç është hapësira në bjeshkët e Sharrit dhe Shtrazës, pjesa lindore e komunës ku ka bukuri të mëdha natyrore.

Më pas, krijimi i zonave ekonomike, duke e koncentruar këtë industri në zona të caktuara, në mënyrë që të ruhet degradimi i tokave bujqësore.

Për krijimin e bizneseve të reja duhet të krijohen "inkubatorët", me qëllim që të krijohen lehtësira për bizneset e reja, me të gjitha infrastrukturën e nevojshme dhe duhet t'u sigurohen vende të mira - lehta për qasje në rrjetin e infrastrukturës.

Promovimi i shumëllojshmërisë së ekonomisë e veçanërisht të sektorëve të identifikuar.

Autoritetet në komunën e Kaçanikut duhet të ndërmarrin aktivitete të shumta për zhvillimin e mirëfillt të bizneseve, duke filluar nga lehtësimi i qasjes në lokacion, eliminimi i procedurave burokratike në: dhënie e lejes ndërtimit, pëlqimet mjedisore, dhënie e lejes së punës, dhënie e pëlqimit për shfrytëzimin e tokës bujqësore.

Përmirësimi i infrastrukturës, lehtësira të tjera të tatimeve dhe ngarkesave fiskale si dhe pushteti vendor duhet të bashkëpunojë me organizatat lokale dhe ndërkombëtare, si OEK, EICC, REA, USAID dhe të tjera, me qëllim që t'u ofroj ndihmë profesionale dhe financiare këtyre bizneseve.

Bashkëpunimi i bizneseve me Komunën dhe programet e ndryshme të USAID, Komisionit Evropian, Caritas Luxemburgut, ka bërë të mundur që një numër i ndërmarrjeve të vogla e të mesme të përfitojnë mjete financiare për ngritjen e kapaciteteve prodhuese dhe përpunuese, në sektorin e shërbimeve, prodhimtarisë, bujqësisë, pemtarisë, zhvillimi i serave dhe përpunimit të drurit.

Duke identifikuar kahet dhe potencialet e zhvillimit ekonomik në Kaçanik, mund të konkludojmë se Kaçaniku ka një perspektivë të mirë të zhvillimit ekonomik, dhe ky qytet në perspektivë do jetë një qendër e rëndësishme tregtare dhe industriale.

Tabela

Numri i Bizneseve Aktive deri më 31.12.2021 - K.Kaçanik

Sektori	Total
0 Mungon aktiviteti	4
1 Bujqesia; Pylltaria dhe Peshkimi	40
2 Industria nxjerrese	19
3 Industria perpunuese	167
4 Furnizimi me rryme, gaz, avull dhe ajer te kondicionuar	2
5 Furnizimi me uje; Kanalizimi; Aktivitetet e menaxhimit dhe te trajtimit te mbeturinave	8
6 Ndertimtaria	144
7 Tregtia me shumice dhe pakice; Riparimi i mjeteve motorike dhe motocikletave	394
8 Transporti dhe magazinimi	88
9 Akomodimi dhe sherbimi ushqimor	133
10 Informimi dhe komunikimi	24
11 Aktivitetet financiare dhe te sigurimit	6
12 Aktivitetet e patundshmerise	3
13 Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	48
14 Sherbimet administrative dhe mbeshtetese	29
15 Administrimi publik dhe mbrojtja; Sigurimi social i detyrueshem	3
16 Arsimi	14
17 Aktivitetet e shendetit te njeriut dhe te punes sociale	21
18 Artet, Argetimi dhe rekreacioni	28
19 Aktivitetet e tjera sherbyese	100
Total	1275

18. Kategoritë e synuara

Kategoritë e synuara në kuadër të Planit komunal tre vjeçar të banimit në komunën e Kaçanikut, janë të përcaktuara në bazë të Udhëzimit Administrativ numër 21/2010, për Përcaktimin e Përparësisë për Kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit. Ato janë:

1. Familjet që nuk kanë banesë apo shtëpi në pronësi individuale;
2. Kanë mbetur pa shtëpi si pasojë e dëmtimeve të shtëpive gjatë luftës;
3. Familjet që posedojnë sipërfaqe banimi nën normat e banimit të përcaktuara për atë kategori sociale dhe ekonomike;
4. Kategoritë e dala nga lufta dhe ish të përndjekurit politik;
5. Të kthyerit dhe ish komuniteti rom, ashkali, egjiptian (minoritetet);
6. Të riatdhesuarit;
7. Të moshuarit;
8. Të rinjët;
9. Të punësuarit nga buxheti shtetëror.

19 Klasifikimi i nevojave sipas urgjencës së trajtimit të tyre

Përmes Programit komunal tre vjeçar të banimit, komuna synon që të ofron banim të qëndrueshëm për personat dhe familjet që nuk kanë fuqi ekonomike të marrim me qira banesë me çmim të tregut ose ndërtim të banimit të tyre. Me këtë nuk pretendohet që mbrenda afatit prej tri vjetësh t'i plotësojë të gjitha kërkesat por të veprohet hap pas hapi në mënyrë që me kapacitetet e veta modeste financiare dhe mbështetjes nga niveli qendror të zgjidhë sa më shumë çështje për banim.

Duke u bazuar në Ligjin në fuqi si dhe në udhëzimet administrative, Komisioni Komunal, ka bërë identifikimin e kërkesave të paraqitura për banim dhe duke u bazuar në të, ka dalë me faktin se si kërkesa urgjente për zgjidhje të çështjes së banimit me qira joprofitabile janë 120 familje. Mirëpo për këtë duhet edhe një rishikim dhe konsultim me vendimarrësit për ndarjen e kësaj të drejtë.

20 Veprimet kryesore që do të ndërmerren

Komisioni gjatë punës për hartimit e Programit komunal tre vjeçar të banimit ka ardhë në përfundim që duhet të ndërmerren këto veprime:

1. Përcaktimi i parcelave për ndërtim që duhet të jetë pronë komunale,
2. Ndërtimi i objektit kolektiv për dhënie me qira joprofitabile;
3. Vlerësimi i gjendjes ekonomike të familjeve në përputhje me Udhëzimin Administrativ Nr.18/2010 të ligjit Nr.03\L-164;
4. Formimi i Sektorit të banimit në Komunë.

Secila nga këto objektiva i ka të listuara veprimet, treguesit e suksesit, nivelin e prioritetit, mjetet e verifikimit, institucionin përgjegjës për t'i realizu veprimet, mbështetësit, afati kohor brenda të cilit kryhen veprimet si dhe kosto financiare.

1. Përcaktimi i parcelave për ndërtim që duhet të jetë pronë komunale

- 1.1. Marrja e Vendimit nga kryetari i Komunës për Formimin e Komisionit për identifikim të pronës komunale për ndërtim të objektit kolektiv,
- 1.2. Identifikimi i pronës komunale;
- 1.3. Vendimi komunal për ndarjen e parcelës për ndërtim;

2.Ndërtimi i objektit kolektiv për dhënie me qira joprofitabile

- 2.1. Marrja e Vendimit për ndërtimin e objektit kolektiv;
- 2.2. Hartimi i kushteve urbanistike dhe hartimi i detyrës projektuese;
- 2.3. Shpallja e tenderit për hartimin e projektit të ndërtimit;
- 2.4. Përzgjedhja e projektit kryesor;
- 2.5. Nënshkrimi i kontratës mes autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomik fitues i tenderit për hartim të projektit kryesor;
- 1.6 Shpallja e tenderit për ndërtim të objektit;
- 1.7 Përzgjedhja e operatorit ekonomik për ndërtim të objektit;
- 1.8 Nënshkrimi i Kontratës mes autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomik;

2. Vlerësimi i gjendjes ekonomike të familjeve në përputhje me udhëzimin administrativ

- 3.1. Formimi i Komisionit për vlerësim;
- 3.2. Rivlerësimi i gjendjes ekonomike të familjeve që kanë kërkuar zgjidhjen e çështjes së banimit;
- 3.3. Përpilimi i listës përfituese;
- 3.4. Largimi nga lista e familjeve që nuk i plotësojnë kriteret;
- 3.5. Përzgjedhja e familjeve të reja përfituese;
- 4.6. Nënshkrimi kontratave.

4. Të mbështetet zgjidhja edhe përmes “ bonus banimit ”

Kjo bëhet në partneritet publiko-privat. Veprimet që duhet të ndërmerren janë;

- 4.1. Caktimi i vlerës së bonusit për vitin buxhetor;
- 4.2. Formimi i Komisionit për identifikimin e banesave-shtëpive;
- 4.3. Hartimi i listës së banesave-shtëpive të mundshme për dhënie me qira;
- 4.4. Kontaktimi me pronarët e banesave – shtëpive;
- 4.5. Përpilimi i marrëveshjes me pronarët për shfrytëzimin e banesave me qira me bonus;

5. Formimi i sektorit të banimit apo caktimi i zyrtarit përgjegjës për çështjen e banimit.

- 5.1. Kryetari i komunës formon sektorin e banimit apo cakton zyrtarin përgjegjës;

21. Justifikim i veprimeve dhe shpjegimi i rezultateve

Bazuar në gjendjen e rëndë ekonomike dhe kërkesat nga palët në nevojë për zgjidhjen e çështjes së banimit dhe faktit që Komuna e Kaçanikut nuk ka pas mundësi financiare për shkak të buxhetit të vogël dhe mos mbështetjes nga niveli qendror, për të ndihmuar palët në nevojë në këtë drejtim.

Është vlerësuar si nevojë imediate ndërtimi i objektit kolektiv për këtë kategori.

Në vitin 2017 me bashkëfinancim të Komunës dhe MPMS është filluar me ndërtim të një objekti të tillë në Kaçanik të Vjetër me 24 njësi banimi e cila është afër përfundimit.

Duke u nisur nga kapacitetet investive dhe humane të komunës si dhe kërkesave aktuale për zgjidhjen e çështjes së banimit është punuar në gjetjen e një zgjidhje më reale duke propozuar që për tri vjetët e ardhshme të adresohen të gjitha kërkesat (120) për banim dhe të përzgjedhen me prioritet në pajtim me legjislacionin dhe rregulloret përkatëse në fuqi.

Vendosja e ligjshmërisë në objektet komunale për banim në të cilat jetojnë familjet në mënyrë të pa ligjshme, do të ndikojë përveç në obligimin ligjor të Komunës për kthimin e ligjshmërisë po ashtu edhe në alternativën e mundëshme për zbutjen e nevojave që kanë familjet në nevojë.

22 Kohëzgjatja e realizimit të programeve

1. Përcaktimi i parcelave për ndërtim që duhet të jenë pronë komunale

Ky objektiv mund të realizohet brenda afateve ligjore pasi që kemi të bëjmë me veprime administrative dhe e njëjta nuk bart kosto financiare pasi mund të kryhet nga administrata komunale.

2. Ndërtimi i objektit kolektiv për dhënie me qira joprofitabile

Ky objektiv planifikohet të kryhet brenda afatit tre vjeçar d.m.th ndërtimi i së paku një objekti banesor, për dhënie me qira joprofitabile.

4. Të mbështetet zgjidhja e çështjes së banimit përmes “ bonus banimit ”

Ky objektiv mund të realizohet brenda afateve ligjore pasi që kemi të bëjmë me veprime administrative dhe e njëjta nuk bart kosto financiare pasi mund të kryhet nga administrata komunale - Komisioni i caktuar me Vendim të Kryetarit.

5. Formimi i sektorit të banimit apo caktimi i zyrtarit përgjegjës për çështjen e banimit

Kryetari konform kompetencave të tija ligjore dhe nevojës për zbatimin e këtij programi në të gjitha fazat, formon sektorin e banimit apo cakton zyrtarin përgjegjës që do të kryej këto punë konform Ligjit Nr.03/L-164, Për financimin e programeve të veçanta të banimit dhe Udhëzimeve administrative që kanë të bëjnë me këtë çështje. Ky zyrtar mund të jetë pjesë e DUKMM apo DSHMS.

23. Korniza e shpenzimeve afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur planifikimet buxhetore në KAB 2022-2023, për Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Në Kuadër të saj janë të parapara: Pagat, Mallrat e shërbimet, Komunalitë, Subvencionet dhe Investimet kapitale.

Korniza afatmesme e shpenzimeve 2022-2023- Granti për shëndetësi.

Burimet e financimit	2022	2023	2024
Granti për shëndetësi	1,186,004.00	1,186,004.00	1,171,004.00

24. Korniza buxhetore 2022-2025, në mënyrë tabelare

Vitet	2022	2023	2024
Pagat	5,289,742.00	5,358,683.00	5,530,089.83
Total M&SH	909,423.00	1,005,484.00	1,059,423.17
Huamarrja në Arsim – Mallra dhe Shërbime	-	17,847.00	10,411.00
Shpenzimet Komunale	221,000.00	485,000.00	460,000.00
Subvencionet	300,000.00	322,967.00	322,967.00
Investimet kapitale	2,473,000.00	5,505,000.00	2,750,000.00

Komuna e Kaçanikut për vitin 2022, për çështjen e banimit, ka ndarë 200,000.00 €, për ndërtimin e objektit për banim social në Kaçanik të Vjetër.

Me rishikimin e buxhetit, duhet të shikohen mundësitë e ndarjes së mjeteve financiare për vazhdimin e këtij programi.

25. Mundësitë e kapaciteteve njerëzore dhe materiale

Mundësitë, gjegjësisht kapacitetet materiale dhe njerëzore janë ndër sfidat kryesore në

realizueshmërinë e shumë objektivave të parapara në Programin komunal tre vjeçar të banimit. Fakti që edhe pas disa viteve të miratimit të Ligjit, nuk është iniciuar ndonjë aktivitet në këtë drejtim dhe ende nuk janë themeluar sektori i banimit apo nuk është caktuar zyrtari përgjegjës për qështjen e banimit, tregon për mungesën e kapaciteteve njerëzore e financiare për zbatim të ligjit. Duhet që të mirren hapa konkret që në strukturën komunale të gjendet vend për themelimin e sektorit të banimit apo caktimin e zyrtarit përgjegjës, duke bërë sistemimin nga kuadri-stafi ekzistues komunal.

26. Mënyra e financimit të programeve komunale tre vjeçare të banimit

Emri i projektit	Periudha kohore	Etazhiteti	Kosto investive	Burimi financiar	Vërejtje
Ndërtimi i një objekti kolektiv për strehim	2022-2025	P+3	500,000.00	Ministria, Komuna, Donatorët	2 vite
Strehimi përmes “ Bonus – Banimit”	2022-2025	/	/	MMPH Komuna	2 vite
Zyrtari përgjegjës	2022-2025	/	/	Komuna	2 vite

27. Përputhja e programeve me planet zhvillimore të komunës

Programi komunal tre vjeçar i banimit është hartuar në përputhje me ligjet ekzistuese të Republikës së Kosovës. Objektivat e programit janë punuar në atë mënyrë që të jenë në përputhje me PZHU dhe Planet tjera që punohen brenda periudhës për të cilën është hartuar ky program.

28. Instrumentet mbikëqyrëse

Drejtorja e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Drejtorja për Shëndetësi e Mirëqenie Sociale së bashku me sektorin e banimit që duhet të themelohet apo zyrtarin përgjegjës, do të jenë përgjegjës për koordinimin e të gjitha aktiviteteve të planifikuara. Kjo mënyrë i mundëson fillimisht komunës që të ketë mbikëqyrje direkte në zbatimin e Programit komunal tre vjeçar të banimit dhe raportimin e rregullt në çdo gjashtë muaj në Kuvendin Komunal, mbi të arriturat dhe pengesat në zbatimin e programit.

Po ashtu kompetencë mbikëqyrëse ka edhe MMPH përmes inspektorëve kompetent.

29. Instrumentet e garantimit të realizimit të programeve

Monitorimi i procesit të zbatimit të programit, vlerësimi i treguesve të suksesit për afatin e paraparë të veprimit si dhe bërja transparente e këtij vlerësimi e garanton realizimin më të efektshëm të programit. Monitorimi është një mjet i domosdoshëm për sigurimin e vazhdimsisë së zbatimit duke i adresuar dhe përshtatur ndryshimet dhe pengesat në proces dhe në këtë mënyrë ai përfshin këto aktivitete:

- Shkalla e suksesit të Programit në krahasim Planin e Veprimit,
- Planifikimi i fondeve dhe harmonizimi i tyre në raport me afatet kohore,

- Ndryshimet e mundshme të cilat mund të ndikojnë në realizimin e projekteve (individët, organizatat),
- Ndryshimet e jashtme që mund të ndikojnë në Planin e Veprimit, si dhe propozimet për alternativat e zgjidhjeve të ndikuara nga faktorët tjerë - harmonizimi.

Bërja publike e raporteve të vlerësimit e bënë edhe më të qëndrueshëm zbatimin e Programit komunal tre vjeçar të banimit.

30. Masat e marra për respektimin e kuadrit ligjor

Kjo pjesë do të jetë në vazhdimësi pjesë e punës së autoriteteve komunale për të cilat do të zbatohet monitorimi dhe auditimi.

31. Përfshirja e publikut në procesin e sigurimit të transparencës

PTB duhet të jetë hartuar në konsultim me qytetarët dhe në interes të tyre andaj përfshirja e tyre që në fazën e hershme të mbledhjes së të dhënave e deri të përcaktimi i objektivave do t'a kishin pasuruar programin si dhe do ta bënin atë më të zbatueshëm. Mirëpo këtë proces në komunën e Kaçanikut, i kanë paraprirë kufizimet në vijim të cilat e kanë determinuar edhe sigurimin e kufizuar të transparencës.

- Mungesa e sektorit të banimit apo zyrtarit përgjegjës, për të udhëhequr procesin;
- Mungesa e përvojës komunale në bërjen e analizës së pjesëmarrësve në proces për fushë të banimit;
- Mungesa e organizimit të përgjithshëm për këtë proces për realizimin e takimeve, fushatës, etj.

32. Çështjet tjera

Gjatë hartimit të programeve tre vjeçare janë marrë parasysh këto standarde

- Realizueshmëria
- Qëndrueshmëria
- Efektshmëria
- Mjaftueshmëria e kapaciteteve njerëzore dhe materiale
- Respektimi i ligjit
- Barazia
- Ndikimi në mjedis dhe energjia e pastër
- Normat e banimit
- Ndërthurja e këtyre programeve me politikat qendrore të banimit
- Transparenca
- Standarde të tjera

33. Analizat SWOT

Anët e forta ose Arritjet	Dobësitë	Mundësitë	Rreziqet
1. Infrastruktura ligjore nga fusha e banimit 2. Numri i kërkesave të përcaktuara, 3. Infrastruktura e mirë, 4. Disponueshmëria e pronës komunale për destinim për qëllim të tillë, 5. Përkrahja në hartimin e projektit nga Kryetari dhe MMPH, 6. Të dhënat nga regjistrimi i popullsisë.	1. Mungesa e sektorit të banimit, 2. Mjetet e pa mjaftueshme buxhetore për ndërtimin e objektit të banimit social, 3. Mos përfshirja e çështjes së banimit social në PZHK dhe PZHU, 4. Prona e kufizuar komunale për banim social, 5. Mungesa e dokumunteve të mëhershme të banimit, 6. Mos përkrahja e donatoreve për ndërtimin e objekteve për banim social	1. Aprovimi i dokumentit nga Kuvendi Komunal, 2. Ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe profesionale nga niveli qendror, 4. Shkëmbimi i përvojave me komunat dhe Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor, 5. Krijimi i fondit për financimin e banimit social.	1. Mos respektimi i Legjislacionit, 2. Rritja e nr të kërkesave, 3. Mungesa e fondeve në nivel lokal, 4. Moszbatimi i Dokumentacionit, 5. Mos krijimi i strukturës për banim, 6. Mungesa e financimit nga donoret për realizimin e projekteve.

Përfundimet:

Nevoja për hartimin dhe zbatimi i efektshëm i planeve për banim sipas programeve të veçanta kërkon koordinimin e aktiviteteve të të gjithë akterëve në kuadër të komunës, në përputhje me kompetencat e përcaktuara.

Në këtë drejtim është i nevojshëm formimi i Sektorit për banim apo caktimi i zyrtarit përgjegjës për banim, si organ përgjegjës që në mënyrë aktive të zhvillojë procesin e zbatimit të aktiviteteve sipas këtij plani.

Ndërtimi i njësive të reja të banimit sipas standardeve, me fonde nga buxheti komunal, qeverisë, donatorëve apo edhe partaneriteti publik-privat, që do të sigurojë banimin për grupe të caktuara. Përmirësimi i kualitetit të banimit duke pasur parasysh objektet ekzistuese të banimit kolektiv që në një masë sektori i banimit do të ndikojë në ngritjen e vetëdijes dhe motivimin e pronarëve të njësive të banimit si domosdëshmëri e organizimit dhe menaxhimit.

Bazuar në këtë, zhvillimi i banimit orientohet nga:

- Përkrahja në zgjidhjen e çështjes së banimit me banimin me qira joprofitabile ose në “bonus banimin” për banesat e tregut me qira të ulët;
- Stimulimi i ofertës dhe kërkesës;
- Mbështetje për grupet e rrezikuara për zgjidhjen e problemit të banimit;
- Rritja e ofertës së banesave joprofitabile, zvogëlimin – kufizimin e profitit nga ndërtimet, por jo të rrezikohet interesi i investitorëve që të zhvillojë aktivitete ndërtimore të banimit;
- Mirëmbajtja dhe menaxhimi i fondit banesor.




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



1	Data	17.05.22	Vendi	KAÇANIK
Hj. org.	Numri	Shtojcë		
01	104/02-13273			

KAÇANIKU



PLANI KOMUNAL PËR INTEGRITET 2022-2026

KOMUNA E KAÇANIKUT

Mars, 2022

Faqe 1 nga 60

Plani komunal për integritet

Adresa: Rr. "Qamil Ilazi" Nr. 28, 71000 Kaçanik;

Përmbajtja

Deklarata e Integritetit	3
HYRJE	4
PLANI PËR INTEGRITET	4
Parimet e menaxhimit të Integritetit	6
Lidershipi	6
Përfshirja e personelit	6
Qasja sistemore	6
Objektivat e Planit të Integritetit	6
Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit	6
Fazat e zhvillimit të Planit të Integritetit	7
Metodologjia.....	7
Fushat e përgjithshme të rrezikut	8
Fushat specifike të rrezikut	8
FUSHA E RREZIKUT: Drejtimi dhe Menaxhimi	9
FUSHA E RREZIKUT: Politika e burimeve njerëzore, sjellja etike dhe profesionale e të punësuarve	10
FUSHA E RREZIKUT: Planifikimi dhe menaxhimi financiar	12
FUSHA E RREZIKUT: Komunikimi dhe informimi.....	14
FUSHA E RREZIKUT: Auditimi i brendshëm.....	15
FUSHA E RREZIKUT: Prokurimi publik	17
FUSHA E RREZIKUT: Administrata Komunale	19
FUSHA E RREZIKUT: Konflikti i interesit	21
FUSHA E RREZIKUT: Mospërputhja e funksioneve	22
FUSHA E RREZIKUT: Deklarimi i pasurive	23
FUSHA E RREZIKUT: Kabineti i Kryetarit	24
FUSHA E RREZIKUT: Licencimi i shërbimeve publike dhe i objekteve	26
FUSHA E RREZIKUT: Inspektimi	29
FUSHA E RREZIKUT: Urbanizmi dhe planifikimi	30
FUSHA E RREZIKUT: Edukimi dhe kultura.....	32
FUSHA E RREZIKUT: Shëndetësia dhe mirëqenia sociale	34
FUSHA E RREZIKUT: Bujqësia dhe zhvillimi rural.....	36
Masat e propozuara për përmirësimin e integritetit të komunës	38
Regjistri i rreziqeve të integritetit dhe masat e përmirësimit.....	39

Deklarata e Integritetit

Kjo deklaratë ka për qëllim ofrimin e një deklarate gjithëpërfshirëse që pasqyron qartazi politikat, procedurat dhe masat tona operative përkitazi me integritetin, etikën, kulturën organizative, transparencën dhe llogaridhënien. Deklarata mbështetet në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe aktet tjera komunale rregulluese.

Ky Plan i Integritetit synon të kontribuojë në ndërtimin e një administrate komunale profesionale dhe të modernizuar, të zhvillimit të qëndrueshëm socio-ekonomik lokal, me qëllim të ngritjes së mirëqenies së qytetarëve përmes ofrimit të shërbimeve efektive dhe cilësore për të gjithë.

Përmes Planit të Integritetit, do të promovohet demokracia lokale në mënyrë që Komuna e Kaçanikut të përmbushë objektivat e saj për të përballuar sfidat ekonomike, sociale dhe politike.

Plani i Integritetit është gjithashtu i harmonizuar me obligimet strategjike, të përcaktuara nga Strategjia e Kosovës Kundër Korrupsionit dhe Plani i Veprimit kundër Korrupsionit 2021-2023, në të cilat parashihet roli kyç i komunave në zhvillimin dhe implementimin e kornizës së integritetit. Profesionalizmi, efikasiteti, efektshmëria, kultura organizative, llogaridhënia dhe transparenca në raport me qytetarët do të ndikojnë që të kthejmë integritetin dhe etikën në shtylla kyçe të sistemit tonë të menaxhimit.

Zotohemi që Komuna e Kaçanikut me gjithë sinjeritetin dhe përkushtimin duhet të zhvillojmë me tej kapacitetet e Komunës dhe personelit tonë, për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive të gjitha sfidave që kanë të bëjnë me integritetin, si dhe për të menaxhuar në mënyrë adekuate rreziqet e shumta e të ndryshme të integritetit me të cilat ne ballafaqohemi.

Me plan të integritetit, ne do të zbatojmë në mënyrë sistematike dhe gjithëpërfshirëse standarde, parimet dhe objektiva në parandalimin e korrupsionit dhe sjelljeve tjera të paligjshme dhe joprofesionale. Duke identifikuar rreziqet, planifikimin dhe zbatimin e masave adekuate, ne forcojmë integritetin dhe kulturën kundër-korrupsionit në punën e organeve të administratës komunale.

Ne e kuptojmë se, që të jemi të suksesshëm, menaxhimi i rrezikut të integritetit nuk duhet të jetë një ushtrim i vetëm, por të jetë një proces i vazhdueshëm që përkrah zhvillimin dhe zbatimin e Planit të Integritetit. Andaj, jemi të përkushtuar që jo vetëm të zbatojmë masat e planifikuara, por edhe të bëjmë përpjekje për të integruar menaxhimin e rrezikut ndaj integritetit në kulturën organizative të Komunës në mënyrë të qëndrueshme. Të gjithë ne jemi përgjegjës për parandalimin efikas, zbulimin me kohë dhe hetimin e korrupsionit, mashtrimit apo çdo shkeljeje tjetër të integritetit në komunë.

Integriteti është zgjedhja, si individë, si organizatë dhe si institucion publik, që përfaqësojmë interesat e qytetarëve, që vazhdimisht t'i përmbahemi etikës dhe standardeve profesionale dhe të veprojmë sipas parimeve demokratike, ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.

Andaj, ne besojmë që ky plan i integritetit do të jetë një ndihmesë në luftën kundër korrupsionit, në krijimin e një kulture organizative të punës dhe respektimit të kodit etik, në mënyrë që qytetarëve t'u kthehet besimi në punën e Komunës së Kaçanikut, dhe shprehim gatishmërinë dhe përkushtimin e duhur për të gjitha përpjekjet për të fuqizuar dhe përmirësuar vazhdimisht sistemin e menaxhimit të integritetit brenda Komunës.

Kryetari i Komunës

Z. Besim Ilazi



HYRJE

Në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe "Strategjinë Shtetërore kundër Korrupsionit" të cilat obligojnë të gjitha institucionet të zhvillojnë dhe miratojnë planet e integritetit, Komuna e Kaçanikut, ka hartuar dhe miratuar Planin e Integritetit për periudhën 2022 -2026.

Plani i integritetit është një mjet për vendosjen dhe verifikimin e integritetit të komunës dhe është një proces i dokumentuar për të vlerësuar nivelin e cënueshmërisë së komunës dhe ekspozimin e tyre ndaj praktikave jo etike dhe të korrupsionit. Plani është dokument operativ, që ofron masa të mbështetura tek rreziku për të arritur objektivat e integritetit të komunës.

Plani rritet përkushtimin e Komunës së Kaçanikut për të shtuar dhe fuqizuar kontrollet ekzistuese operative në të gjitha aktivitetet, duke u fokusuar në ofrimin e shërbimeve efikase, transparente dhe të orientuar kah qytetari. Plani përshkruan masat e bazuara në rrezik për arritjen e objektivave të komunës dhe forcimin e sundimit të ligjit, si dhe vlerat dhe standardet profesionale.

PLANI PËR INTEGRITET

Plani për Integritet është një dokument strategjik dhe operativ që konsiderohet si një mjet i rëndësishëm për fuqizimin e integritetit institucional. Ky plan kuptohet si një respektim i drejtpërdrejtë i vlerave morale, standardeve profesionale dhe i rregullave të zbatueshme normative. Gjithashtu, plani ofron masa të mbështetura tek rreziku për të arritur objektivat e integritetit të komunës.

Plani i integritetit mundëson:

- Identifikimin e rreziqeve përkatëse të korrupsionit në fusha të ndryshme të punës në një Komunë;
- Vlerësimin e çfarëdoj rreziku që mund të paraqes rrezik për shfaqjen e korrupsionit për një komunë; dhe
- Përcaktimin e masave për të parandaluar ose eliminuar rreziqet e Korrupsionit dhe sjelljeve tjera jo profesionale.

Plani i Integritetit do të kontribuojë në mënyrë domethënëse në:

- Rritjen e mundësive që Komuna të arrijë objektivat e saja organizative, duke vënë përpara një menaxhim pro aktiv të rrezikut të integritetit. Kjo do të përmirësojë rezistencën organizative ndaj korrupsionit dhe do të zvogëlojë mundësitë për korrupsion;
- Përqendrimin tek prioritetet, në bazë të identifikimit dhe vlerësimit të rrezikut që do ta ndihmojë komunën të shpërndajë në mënyrë efektive burimet e disponueshme kundër korrupsionit, që të shfrytëzohen në mënyrën më të mirë të mundshme;
- Përmirësimin e kontrolleve Operacionale ndaj shkeljeve të integritetit që do të rrisin efektivitetin, efikasitetin dhe transparencën e të gjitha proceseve, përfshirë ofrimin e shërbimeve për qytetarët;
- Mbajtjen e një sistemi për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat dhe standardet ligjore dhe procedurale;
- Krijimin e një mjedisi të brendshëm të favorshëm kundër korrupsionit përmes trajnimit të synuar dhe ndërgjegjësimit, si dhe duke inkurajuar një bashkëpërgjegjësi të të gjithë stafit në procesin e zhvillimit, zbatimit dhe monitorimit të planeve të integritetit;

Faqe 4 nga 60

Plani komunal për integritet

Adresa: Rr. "Qamil Ilazi" Nr. 28, 71000 Kaçanik;

- Rritjen e besimit të punonjësve komunalë dhe palëve të jashtme të interesit në përkushtimin për integritet që demonstrohet nga Komuna.

Me zbatimin e këtij plani, Komuna do të vendoset më mirë për të siguruar një shpërndarje efektive, efikase, transparente dhe etike të rezultateve të synuara, përfshirë shërbime publike të përmirësuara të qytetarëve dhe grupeve të interesit. Gjithashtu, Komuna do të jetë në pozitë më të mirë për të siguruar efikasitet, efektivitet, transparencë dhe etikë gjatë arritjes së rezultateve të synuara, përfshirë këtu shërbimet më të mira për qytetarët dhe rritje të kënaqshmërisë nga ana e qytetarëve dhe grupeve të interesit.

Plani mbështetet në rezultatet e një planifikimi gjithëpërfshirës për integritetin dhe të një procesi të vlerësimit të rrezikut të bërë nga komuna. Procesi ka përfshirë identifikimin e pikave të dobëta të komunës në rastet e shkeljeve të integritetit dhe vlerësimin e tyre duke marrë parasysh dëmet materiale dhe jo materiale që shkaktojnë shkeljet përkatëse potenciale dhe gjasat që ngjarje të tilla mund të ndodhin duke parë rezistencën aktuale organizative të vërtetuar në rregulloret, procedurat, kodet, praktikën dhe përfshirjen e punonjësve.

Plani mbështetet në rezultatet e një planifikimi gjithëpërfshirës për integritetin dhe të një procesi vlerësimi të rrezikut që Komuna e Kaçanikut e ka bërë në periudhën janar- shkurt 2022. Procesi ka përfshirë identifikimin e pikave të dobëta të Komunës në rastet e shkeljeve të integritetit dhe vlerësimin e tyre duke marrë parasysh (1) dëmet materiale dhe jo materiale që shkaktojnë shkeljet përkatëse potenciale dhe (2) gjasat që këto ngjarje të ndodhin parë nga rezistenca aktuale organizative e vërtetuar nga rregulloret, procedurat, kodet, praktikën relevante dhe nga përfshirja e stafit.

Parimet e menaxhimit të Integritetit

Lidershipi

Menaxhmenti i lartë duhet në mënyrë të dukshme të demonstrojë një përkushtim aktiv të bazuar në fakte për integritetin. Kjo do të kërkonte nga ata që të udhëheqin procesin qysh nga fillimi, përmes zhvillimit të politikave të integritetit dhe Kodit të Etikes. Shumë e rëndësishme është që ky përkushtim të jetë i vazhdueshëm dhe që të kuptohet dhe të shihet mirë nga i gjithë stafi dhe palët interesit.

Përfshirja e personelit

Pjesëmarrja e gjithë stafit është shumë e rëndësishme në zbatimin e suksesshëm të sistemit për menaxhimin e integritetit. Megjithatë, përfshirja kuptimplote kërkon edukimin e përshtatshëm dhe trajnimin lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me integritetin, ngritjen e vetëdijes, duke krijuar kështu besim dhe mjedis pozitiv për punë. Komunikimi efektiv i brendshëm dhe i jashtëm dhe koordinimi janë të rëndësishme për punë të suksesshme ekipore, në mënyrë që të gjitha palët e përfshira të marrin dhe të mbajnë të njëjtin kuptim për projektin derisa është duke u zbatuar.

Qasja sistemore

Identifikimi i fushave potenciale të korrupsionit dhe menaxhimi i proceseve të ndërlidhura për të siguruar integritet kërkon qasje sistemore. Kjo kërkon nga Komunitat që t'iu kushtojnë vëmendje të gjitha njësive dhe të analizojnë marrëdhënien dhe ndërvlerësinë ndërmjet tyre. Një gjë e tillë arrihet brendapërbrenda grupit punues në Komunë.

Objektivat e Planit të Integritetit

Objektivi kryesor i Planit të Integritetit është të rrisë dhe rendit përpjekjet dhe burimet për të parandaluar/eliminuar në mënyrë progresive dhe sistematike shkaqet dhe efektet shkatërruese të korrupsionit dhe të sjelljeve jo etike në Komunë.

Objektivat specifike janë:

- Sigurimi i një mekanizmi gjithëpërfshirës, ku të gjithë individët dhe njësitë në Komunë, si dhe qytetarët mund të përfshihen në luftën kundër korrupsionit dhe sjelljeve jo etike në punën e organeve të administratës komunale.
- Rritja e vetëdijesimit të qytetarëve mbi rreziqet e korrupsionit dhe të sensibilizojnë qytetarët dhe bizneset për rolin e tyre në parandalimin/eliminimin e korrupsionit dhe sjelljeve jo etike.
- Përmirësimi dhe forcimi i mekanizmave të raportimit të rasteve të korrupsionit dhe sjelljeve jo etike në Komunë.
- Rritja e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve komunale.
- Krijimin dhe mirëmbajtjen e partneriteteve në luftën kundër korrupsionit dhe sjelljeve jo etike.

Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit

Plani i Integritetit është një dokument që vlerëson integritetin e punës, integritetin institucional, pajtueshmërinë dhe mënyrën se si institucioni dhe punonjësit e tij veprojnë përmes vetëvlerësimit të ekspozimit ndaj rreziqeve, ndaj ndodhjes dhe zhvillimit të korrupsionit dhe/ose sjelljeve tjera të papranueshme etike dhe profesionale.

Plan i Integritetit kryesisht përbëhet nga:

- Regjistrimi i rrezeqeve të identifikuara dhe të vlerësuara për të gjitha fushat e funksionimit të Komunës.
- Përcaktimi i masave për përmirësimin e integritetit që përshkruan në detaje të gjitha masat që duhet të zbatohen për të zvogëluar rreziqet e integritetit, si dhe afatin kohor përkatës dhe përgjegjësitë organizative për zbatimin e masave.

Me rastin e zhvillimit të Planit të Integritetit bëhet vlerësimi i rrezeqeve të integritetit për të gjitha fushat e funksionimit të Komunës. I gjithë stafi komunal ka mundësi të marrë pjesë në vlerësimin e rrezikut të fushave të funksionimit të Komunës dhe të propozojnë masa për të përmirësuar integritetin dhe cilësinë e përgjithshme të menaxhimit si dhe ofrimin e shërbimeve.

Fazat e zhvillimit të Planit të Integritetit

Zhvillimi i Planit të Integritetit përbëhet prej disa faza si në vijim:

Faza përgatitore - Kryetari i Komunës themelon grupin punues; përcakton strukturën e grupit punues dhe kryesuesin e tij, mund të delegojë një zyrtar për ta udhëhequr grupin; Kryetari emëron koordinatorin për zhvillimin e planit të integritetit; Grupi punues bënë mbledhjen e informacionit të nevojshme për zhvillimin e planit të integritetit si dhe njoftimi i të gjithë stafit për rëndësinë e Planit të Integritetit.

Faza e vlerësimit të rrezikut të integritetit - gjatë kësaj faze koordinatori së bashku me grupin punues analizojnë dokumentacionin e mbledhur (legjislacionin dhe aktet nënligjore të zbatueshme në punën e administratës së komunës; përshkrimet e vendit të punës dhe fushëveprimin e çdo njësie komunale) si dhe çdo proces për vendimmarrje dhe ofrimin e shërbimeve. Mbi bazën e analizës së gjendjes aktuale përcakton fushat e rrezikut dhe bënë identifikimin dhe vlerësimin e rrezeqeve.

Faza e përcaktimit të prioritetëve dhe propozimit të masave për përmirësimin e integritetit - kjo fazë përfshin përcaktimin e prioritetëve për intervenimin, përcaktimi i masave për parandalimin/eliminimin e rrezeqeve dhe përgjegjësit për zbatim.

Faza e monitorimit dhe raportimit të planit të integritetit - përfshin monitorimin, vëzhgimin dhe regjistrimin e rregullt të aktiviteteve që ndodhin në një Plan të Integritetit dhe procesin e mbledhjes së informacionit për të gjitha aspektet e zbatimit të Planit të Integritetit. Ndërsa, raportimi mundëson që informacionet e mbledhura të përdoren në marrjen e vendimeve që përmirëson zbatimin e objektivave të Planit të Integritetit.

Metodologjia

Gjatë zhvillimit të planit të integritetit, komuna ka aplikuar dy metoda kryesore për të analizuar dhe vlerësuar integritetin, dobësitë dhe rreziqet. Kështu, hapi i parë është plotësimi i pyetësorëve nga ana e stafit. Pyetësorët janë një mjet i rëndësishëm për mbledhjen e përgjigjeve të sakta dhe shërbejnë mjaft mirë për të përcaktuar masën dhe nivelin e rrezikut të cenimit të integritetit në mënyrë vullnetare dhe kanë vlefshmëri të lartë të besueshmërisë së të dhënave. Për më tepër, pyetësorët janë mekanizëm i kontrollit në raport të vlerësimit të rrezikut dhe grupi punues ka implementuar këtë formë në lidhje me vlerësimin e integritetit të stafit të brendshëm. Duke përdorur pyetësorët jep mundësi edhe për stafin për të marrë pjesë në mënyrë aktive në gjithë procesin e menaxhimit të rrezikut të korrupsionit.

Me qëllim të marrjes së informacionit të duhur mbi kanosjen e rrezikut të korrupsionit, grupi i punës ka aplikuar metodën e dytë dhe ka bërë intervista me stafin e komunës, duke përfshirë edhe udhëheqësit e procesit të

fushave të identifikuara të rrezikut. Qëllimi i këtyre intervistave ishte që të ofrojë grupit punues informata shtesë dhe sugjerime për përmirësimin e masave të integritetit.

Plani i integritetit duhet të miratohet rregullisht çdo tre vjet, ose më herët nëse mbikëqyrësi dhe personi përgjegjës për implemtimin e masave gjatë monitorimit të implementimit të masave të caktuara vlerëson se masat e propozuara nuk japin rezultatet e pritura.

Fushat e përgjithshme të rrezikut

Në këtë kapitull janë paraqitur rreziqet e identifikuara dhe niveli i përgjithshëm i kanosjes së integritetit të komunës. Fushat e përgjithshme janë:

- Drejtimi dhe menaxhimi;
- Politika e burimeve njerëzore, sjellja etike dhe profesionale e të punësuarve;
- Planifikimi dhe menaxhimi financiar;
- Komunikimi dhe informimi;

Fushat specifike të rrezikut:

- Auditimi i brendshëm;
- Prokurimi publik;
- Administrata Komunale;
- Konflikti i interesit;
- Mospërputhja e funksioneve;
- Deklarimi i pasurive;
- Kabineti i Kryetarit;
- Licencimi i shërbimeve publike dhe i objekteve;
- Inspektimi;
- Urbanizmi dhe planifikimi;
